

# UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E NJË PROGRAMI MENTORIMI MBI AKSESIN E GRAVE NË DREJTËSI PËR PROFESIONISTËT E SË DREJTËS



Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar  
nga Këshilli i Evropës



Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



Bashkëfinancuar dhe zbatuar  
nga Këshilli i Evropës

# **UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E NJË PROGRAMI MENTORIMI MBI AKSESIN E GRAVE NË DREJTËSI PËR PROFESIONISTËT E SË DREJTËS**

Përgatiti:

**Zora Csalagovits dhe Elisabeth Duban**

Shtator 2023

Titulli i botimit origjinal:  
"GUIDE FOR DEVELOPING A MENTORING  
PROGRAMME ON WOMEN'S ACCESS TO JUSTICE  
FOR LEGAL PROFESSIONALS"

Ky dokument është përgatitur në kuadër të programit Partneriteti për Qeverisje të Mirë (PGG) dhe është përkthyer në kuadër të programit Instrumenti Horizontal III, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Europës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit (autorëve). Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian ose të Këshillit të Evropës.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "©Këshilli i Evropës, 2023". Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int). Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Directorate of Communications, Council of Europe (F-67075 Strasbourg Cedex ili na publishing@coe.int)

Imazhi i kopertinës është përdorur me autorizimin e licencës Shutterstock Premier.

@ Këshilli i Evropës, 2023.  
Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

# PASQYRA E LËNDËS

---

<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
<b>OBJEKTIVAT</b> .....	<b>6</b>
<b>PROCESI DHE METODOLOGJIA</b> .....	<b>7</b>
Fillimi i procesit të mentorimit hap pas hapi .....	7
<b>KAMPION PËRMBAJTJEJE PËR PROGRAMIN E MENTORIMIT</b> .....	<b>11</b>
Sesioni 1: Hyrje: të njohim njëri-tjetrin dhe të përcaktojmë objektivat .....	16
Sesioni 2: Si lidhet "aksesi i grave në drejtësi" me mua? .....	18
Sesioni 3: "Drejtësia është e verbër" nuk do të thotë "e verbër në aspektin gjinor"! .....	21
Sesioni 4: Eksplorimi i pengesave të aksesit të grave në drejtësi .....	24
Sesioni 5: Aksesit në drejtësi në rastet e dhunës ndaj grave .....	28
Sesioni 6: Zbatimi i të drejtës ndërkombëtare lidhur me të drejtat e grave në gjykatat kombëtare .....	32
Sesioni 7: Puna me jurisprudencën .....	34
Sesioni 8: Çfarë mund të bëhet për të eliminuar stereotipet gjinore në proceset gjyqësore? .....	38
Sesioni 9: Përdorimi i praktikave të ndjeshme gjinore në jetën reale .....	41
Sesioni 10: Vlerësimi, hapat pasardhës dhe mbyllja .....	43
<b>BURIME SHITESË PËR ZHVILLIMIN E SESIONEVE TË MENTORIMIT</b> .....	<b>44</b>
<b>SHTOJCAT</b> .....	<b>47</b>
(1) Formulari i raportit të sesionit të mentorimit (për mentorët) .....	48
(2) Formulari i raportit përfundimtar të mentorimit (për të mentoruarit) .....	50
(3) Formulari i raportit përfundimtar të mentorimit (për mentorët) .....	53



Garantimi i aksesit të barabartë të grave në drejtësi është një prioritet thelbësor për Këshillin e Evropës në mënyrë që të sigurohet barazia gjinore në të gjitha shtetet anëtare. Një ndër gjashtë fushat kryesore strategjike për punën e Këshillit të Evropës në periudhën 2018-2023 është trajtimi i faktit se “pabarazitë e vazhdueshme ekonomike dhe sociale midis grave dhe burrave, paragjykimet gjinore dhe stereotipet gjinore çojnë në akses të pabarabartë të grave dhe burrave në drejtësi”<sup>1</sup>. Për këtë qëllim, Këshilli i Evropës ka mbështetur shumë studime mbi pengesat për akses në drejtësi me të cilat përballen shpesh gratë dhe ka organizuar disa konferenca në nivel ekspertësh.

Në kuadër të projekteve konkrete për aksesin e grave në drejtësi në gjashtë vendet e Partneritetit Lindor (Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Gjeorgji, Republika e Moldavisë dhe Ukrainë), Këshilli i Evropës e ka përqendruar vëmendjen te zhvillimi i mjeteve për profesionistët e së drejtës në mënyrë që të rrisë kompetencat e tyre për të përmirësuar sistemet e drejtësisë ku ata punojnë. Burimet kryesore të prodhuara nga ky projekt deri tani janë:

- ▶ *Manuali i Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët mbi Sigurimin e Aksesit të Grave në Drejtësi* (2017)<sup>2</sup>
- ▶ Kursi online mbi *Aksesin e Grave në Drejtësi* brenda platformës HELP [Edukimi mbi të Drejtat e Njeriut për Profesionistët e së Drejtës].
- ▶ Studime të vendit mbi pengesat, mjetet juridike dhe praktikat e mira për aksesin e grave në drejtësi: Armeni, Azerbajxhan, Gjeorgji, Republika e Moldavisë, Ukrainë (2017)
- ▶ Fleta e fakteve mbi aksesin e grave në drejtësi – *Akresi i Grave në Drejtësi: Udhëzues për Profesionistët e së Drejtës* (2018)<sup>3</sup>

Ky udhëzues përfaqëson hapin tjetër të projektit për *Aksesin e Grave në Drejtësi*. **Udhëzuesi është një mjet që mbështet zhvillimin e një programi mentorimi** mbi temën e aksesit të barabartë të grave në drejtësi. Programi i Mentorimit është projektuar për të përmirësuar mësimin e vazhdueshëm të profesionistëve të së drejtës, veçanërisht gjyqtarëve dhe prokurorëve.

---

1. Strategjia për Barazinë Gjinore e Këshillit të Evropës për periudhën 2018-2023.  
2. [https://www.coe.int/en/web/genderequality/equal-access-of-women-to-justice#{"14965347":}\[0\]}](https://www.coe.int/en/web/genderequality/equal-access-of-women-to-justice#{)  
3. <https://rm.coe.int/factsheet-womens-access-to-justice/16808ff44e>

# OBJEKTIVAT

---

Programi i Mentorimit synon të mbushë hendekun midis materialit që është paraqitur në manualin e trajnimit dhe kursit online HELP dhe llojeve të veprimeve që prokurorët dhe gjyqtarët mund të ndërmarrin në punën e tyre. Duke përdorur një qasje të ndryshme nga qasja e përdorur në mësimdhënien tradicionale në klasë, tekstet ose manualet klasike, metodologjia e mentorimit synon të krijojë një lidhje midis teorive për aksesin në drejtësi, të drejtës ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe praktikës së përditshme të profesionistëve të së drejtës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fushave konkrete ku hasen zakonisht vështirësi. Mentorimi angazhon “studentin” (personin që mentorohet) për të drejtuar procesin e të nxënit, në mënyrë që mentorimi të ketë lidhje për përvojën e tij/saj të punës.

Duke përdorur këtë udhëzues, procesi i mentorimit do t’u lejojë të personave që mentorohen të përqendrohen në tri aspekte të përmirësimit të aksesit të grave në drejtësi:

- ▶ lidhjen e koncepteve abstrakte me punën e tyre të përditshme;
- ▶ referimin te e drejta ndërkombëtare kur trajtojnë çështjet në gjykatat kombëtare;
- ▶ identifikimin dhe reagimin ndaj stereotipeve gjinore dhe paragjykimeve gjinore në praktikën ligjore.

Përmes reflektimit se si drejtësia e përgjegjshme gjinore mund të funksionojë në praktikën e vetë të mentoruarve, ata do të jenë në gjendje:

- ▶ të zhvillojnë vlera të reja, veçanërisht pikëpamje të ndjeshme gjinore për aksesin në drejtësi;
- ▶ të bëhen ambasadorë për ta bërë praktikën ligjore më të aksesueshme për gratë;
- ▶ të ndihmojnë për forcimin e kompetencave të profesionistëve të tjerë ligjorë për të garantuar akses të barabartë në drejtësi për gratë dhe burrat (qoftë përmes mentorimit të mëtejshëm, joformal ose formal, ose duke shërbyer si modele në profesionet e tyre).



# PROCESI DHE METODOLOGJIA

## Çfarë është mentorimi? Kush është mentor?

Mentorimi është një koncept që kuptohet dhe interpretohet në mënyra të ndryshme në sektorë të ndryshëm të arsimit. Këto dallime manifestohen kryesisht në cilësinë e marrëdhënies ndërmjet mentorit dhe të mentoruarit, metodologjisë së përdorur dhe rezultatit të përgjithshëm të pritshëm të procesit mësimor. Megjithatë, është pranuar përgjithësisht se mentorimi ka të bëjë kryesisht me **mbështetjen e njerëzve për të mësuar dhe për dhe t'u zhvilluar në mënyrë më efektive sesa do të bënin vetëm.**

Në këtë projekt mbi *Aksesin e Grave në Drejtësi* ne e përkufizojmë mentorimin si një formë komunikimi mbështetës midis një mentori dhe një profesionisti tjetër të së drejtës, duke lehtësuar reflektimin dhe duke zgjeruar ndërgjegjësimin për një qasje të ndjeshme gjinore në sektorin e drejtësisë. Për rrjedhojë, mentori duhet të jetë në gjendje të shohë lidhjen midis temës dhe implikimeve praktike të këtyre teorive në punën e përditshme të të mentoruarit. Mentori duhet të jetë në gjendje të dëgjojë dhe të bëjë pyetje që e mbështesin të mentoruarin për të identifikuar kursin e veprimit që ai/ajo mund të marrë në mënyrë që të zhvillojë punën dhe qasjen e tij/saj për sa i përket ndjeshmërisë gjinore.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i procesit është se mentori është një person i jashtëm; mentori nuk është i përfshirë drejtpërdrejt në punën e përditshme të të mentoruarit, por ai/ajo është përgjegjës për mbështetjen dhe inkurajimin e të mentoruarve që të punojnë drejt përbushjes së objektivave të tyre individuale. Mentori është shoqëruesi gjatë rrugëtimit mësimor.

Mentorimi është një instrument i fuqishëm sepse ai:

- ▶ krijon hapësirë për dialog dhe reflektim;
- ▶ ka në qendër njerëzit;
- ▶ promovon partneritete të barabarta në procesin e të nxënit;
- ▶ nxit shkëmbime profesionale me cilësi të lartë lidhur me temën e mentorimit për shkak të faktit se mentori vjen nga i njëjti sektor;
- ▶ lejon fleksibilitet për t'u përshtatur me nevojat e të mentoruarit,
- ▶ është individual, secila marrëdhënie do të jetë unike për të dy individët e përfshirë;
- ▶ plotëson masat e tjera të të nxënit.

## Si të mentorosh

Aftësitë dhe përvojat që i nevojiten një mentori:

- ▶ Ekspertizë e fushës/sectorit - mentori duhet të njohë proceset dhe kontekstin brenda sektorit të drejtësisë në rajon/vendin e tij/saj;
- ▶ Besueshmëri – mentori duhet të ketë besueshmëri personale dhe profesionale. Kjo i referohet kryesisht një lidhjeje personale dhe përvojave profesionale në fushën e drejtësisë;
- ▶ Aftësia për të krijuar një hapësirë të sigurt dhe për të fuqizuar – mentori duhet të jetë në gjendje të krijojë një mjedis pune të sigurt për individët, në mënyrë që ata të reflektojnë mbi paragjykimet e tyre dhe të ndihen të fuqizuar për të dalë me ide të reja për profesionin e tyre;
- ▶ Vetë-ndërgjegjësimi – një mentor duhet të ketë një kuptim të mirë të pikave të veta të forta dhe të nevojave për zhvillim në mënyrë që të jetë në gjendje të mbështesë të tjerët në procesin e të nxënit;
- ▶ Aksesueshmëria – mentori duhet të jetë i gatshëm dhe në gjendje t'u kushtojë kohë të mjaftueshme të mentoruarve për të ofruar mbështetje dhe udhëzime për ta;
- ▶ Komunikimi – mentori duhet të ketë aftësi të mira komunikimi dhe dëgjimi dhe duhet të jetë në gjendje të kuptojë idetë dhe ndjenjat e të tjerëve;
- ▶ Të qenit i hapur dhe empatia – mentori duhet të jetë i hapur ndaj mënyrave të reja të të bërit të gjërave dhe mënyrave të ndryshme të punës dhe duhet të ketë empati për të mentoruarit.

## Dallimi midis mësuesit dhe mentorit

Mësimdhënia ka të bëjë me njohuritë, mentorimi ka të bëjë me përvojën.

	Mësuesi	Mentori
<b>Individi/grupi</b>	Komunikon me një grup studentësh/nxënësish	Kryesisht marrëdhënie 1 me 1, ndonjëherë me një grup të vogël njerëzish
<b>Njohja e përvojës</b>	Nota, diploma	Nuk jepen nota, certifikata
<b>Motivimi</b>	Pjesëmarrje e detyrueshme/vullnetare	Pjesëmarrje me vetë-motivim
<b>Të nxënit</b>	Njohuritë dhe informacioni jepen përmes udhëzimeve dhe shpjegimeve	Informacioni plotësohet duke mësuar nga përvoja dhe përmes reflektimeve; ka shkëmbim midis të dyve, ndërsa mentorët synojnë t'i ndihmojnë personat që mentorojnë që të zhvillohen si kolegë
<b>Vëmendja</b>	I kushtohet vëmendje se çfarë të bëhet dhe se si të bëhet diçka, në mënyrë që të përmbushet objektivi i përcaktuar	Më shumë vëmendje i kushtohet zbatimit të njohurive në praktikë. Jo vetëm si të bëhet diçka, por pse është e dobishme që diçka të bëhet në një mënyrë të caktuar
<b>Dinamika nxënës-mësues/mentor</b>	Hierarkia është e caktuar paraprakisht	Partneritet i barabartë midis mentorit dhe të mentoruarit
<b>Përmbajtja</b>	Përmbajtja është e standardizuar	Përmbajtja ndërtohet sipas nevojave të të mentoruarit
<b>Vlerësimi</b>	Vlerësim i jashtëm, provim	Vetëvlerësim

## Procesi i mentorimit

Në kuadër të këtij projekti, është hartuar një mostër e procesit të mentorimit me hapa dhe udhëzime konkrete. Megjithatë, është e rëndësishme të mbahet parasysh fleksibiliteti i procesit dhe përshtatja e nevojshme me nevojat e të mentoruarve. Hapat shërbejnë si udhëzues dhe rekomandime, hapa për t'u përdorur sipas kontekstit dhe mundësive.

Fazat e mëposhtme janë baza e procesit të mentorimit:



## Përcaktimi i objektivave për të mentoruarit

Objektivat e procesit të mentorimit duhet të jenë konkrete dhe realiste, objektiva për të cilat mentori dhe i mentoruari bien dakord në fillim të procesit.

Një shembull i një objektivi mund të jetë: gjatë procesit të mentorimit, i mentoruari duhet të mësojë të njohë lidhjet midis punës së tij/saj të përditshme lidhur me çështjet që shqyrton dhe standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

## Afati (përafërsisht tetë muaj)

Procesi i mentorimit është projektuar të zgjasë përafërsisht **tetë muaj** për të siguruar nxënie maksimale. Takimet e mentorimit duhet të planifikohen të paktën një herë në muaj për të siguruar një kurbë nxënieje pa ndërprerje. Seancat e propozuara mund të riorganizohen dhe/ose të rishikohen nëse është e nevojshme. Disa tema mund të kërkojnë më shumë kohë sesa një seancë mentorimi.

### Fillimi i procesit të mentorimit hap pas hapi

#### 1. Kuptoni, menaxhoni pritshmëritë dhe krijoni një pikënisje të përbashkët

Kur takoni për herë të parë me të mentoruarin, bëjini atë të ndihen rehat duke i shpjeguar çfarë roli keni ju dhe cili është qëllimi i Programit të Mentorimit.

Përgjigjuni çdo pyetjeje që mund të ketë lidhje me procesin e mentorimit.

Shpjegoni se çfarë prisni prej tij/saj (p.sh. të vijë i përgatitur me kazuse/ide/probleme për të zgjidhur ose pyetje për të diskutuar; të takoheni rregullisht, etj.).

Shpjegoni se çfarë jeni gati të bëni dhe t'i siguroni atij/asaj: konsultime, materiale mësimore, diskutime, shembuj me çështje..

#### 2. Kryeni një vlerësim joformal të nevojave dhe përcaktoni objektivat së bashku

Pyeteni të mentoruarin se cilat janë prioritetet e tij/saj sa i takon takimeve me ju. Për cilat aspekte të ndjeshmërisë gjinore/aksesit të grave në drejtësi dëshiron më shumë informacion? Në cilat fusha shpreson të përmirësohet? Formuloni 1-3 objektiva të veçanta mësimore bazuar në nevojat e të mentoruarit dhe temën e Programit të Mentorimit..

#### 3. Përcaktoni kalendarin/orarin e takimeve

Sa shpesh do të takoheni me të mentoruarin? A do të ketë seanca mentorimi në grup, apo vetëm seanca individuale? Si do të kontaktoni lidhur me takimet (me telefon, postë elektronike?), cili është kanali më i përshtatshëm i komunikimit për të dy ju?

#### 4. Së pari dëgjoni me kujdes, më pas pyesni dhe këshilloni. Mos i udhëzoni të mentoruarit se çfarë të bëjnë

Ju keni të gjitha llojet e përvojave dhe njohurive të grumbulluara ndër vite. Megjithatë, i mentoruari nuk është një kuti boshe ku ju duhet të vendosni ekspertizën tuaj; qëllimi juaj është më shumë që ta bëni atë që të kuptojnë vetë se cilat janë pikat kryesore që duhet të dijë, jo t'i tregoni se sa të zotët jeni, apo sa shumë dini.

Do të ishte e lehtë thjesht t'u tregoni të mentoruarit se çfarë të bëjë, por kjo nuk do ta lejonte atë që të kalonte përvojën e të menduarit përmes sfidave për të arritur tek zgjidhjet e tij/saj.

Përqendrohuni te ajo që ka për të thënë i mentoruari përpara se të jepni mendimin tuaj. Pyetni atë për këndvështrimin e vet. Të mentoruarit sjellin njohuri dhe perspektiva nga të cilat mund të mësoni dhe ju.

### **5. Kontrolloni paragjykimet**

Mundohuni të mos lejoni stereotipet që të shtrembërojnë përshtypjet tuaja. Mos harroni se të gjithë jemi të anshëm. Kontrolloni përshtypjet tuaja herë pas here.

### **6. Mos u frikësoni nëse nuk dini një përgjigje**

Mentorët nuk janë kompjuterë apo enciklopedi që kanë të gjitha përgjigjet për një temë të caktuar. Mbani parasysh, kjo është një gjë e mirë, jo një shenjë dobësie. Kërkoni mbështetje nga kolegët kur është e nevojshme. Kthejeni pasigurinë tuaj në lidhje me një përgjigje në një mundësi për të mësuar (dhe për të mentoruar).

### **7. Tregoni mbështetje dhe përkushtimi**

Mendojeni veten si instruktor makine: Ju qëndroni i ulur në krah të pasagjerit, duke i lejuar të mentoruarit kontroll të plotë mbi udhëtimin. Megjithatë, ju jeni i pranishëm për të ofruar këshilla dhe udhëzime ose për të tërhequr frenën e urgjencës nëse është e nevojshme.

## **Mbështetja për mentorët**

Edhe mentorët mund të ndjejnë nevojë për mbështetje në rolin e tyre; ata mund të përballen ose të kenë të bëjnë me situata me të mentoruarit ku nuk janë të sigurt se si ta trajtojnë. Ky udhëzues ofron mbështetje metodologjike për mentorët (të përfshira në përshkrimet e sesionit si këshilla dhe sugjerime) si dhe disa burime për t'u lexuar ose për studim shtesë, të cilat përmenden në të gjithë Udhëzuesin. Mentorët gjithashtu mund të marrin mbështetje nga kolegët. Mentorët inkurajohen të mbështesin njëri-tjetrin.

# KAMPION PËRMBAJTJEJE PËR PROGRAMIN E MENTORIMIT

Materiali në këtë seksion përbëhet nga dhjetë tema të veçanta, ose “sesione”, të cilat janë projektuar për t’u përdorur për këtë Program Mentorimi që shtrihet në tetë muaj. Seancat prezantohen sipas një rendi që ndjek përafërsisht krerët e *Manualit të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët për Sigurimin e Aksesit së Grave në Drejtësi* dhe modulet e kursit online HELP mbi *Aksesin e Grave në Drejtësi*. Megjithatë, përveç seancës së parë dhe të fundit, të gjitha seancat e tjera synohen të jenë të ndryshueshme, në mënyrë që mentori të ketë fleksibilitet për të vendosur se si të punojë nga njëri sesion te tjetri. Udhëzuesi jep sugjerime për mënyra të ndryshme se si mund të përdoret çdo seancë, megjithatë, ne inkurajomë fort kreativitetin dhe përshtatshmërinë!

Inkurajimi i profesionistit të së drejtës ose të mentoruarit për të identifikuar pengesat e mundshme të aksesit të grave në drejtësi në sistemet e tyre ligjore dhe për të menduar ndryshe se si mund të funksionojë sistemi i drejtësisë është pjesë shumë e rëndësishme e procesit të mentorimit. Si manuali i trajnimit ashtu edhe kursi HELP përfshijnë pyetje të hapura të projektuara për të nxitur diskutime. Programi i Mentorimit ofron edhe më shumë mundësi për mësim të udhëzuar, ku i mentoruari mund t’i eksplorojë më thellë këto çështje dhe të reflektojë mbi praktikën dhe supozimet e veta. Kjo do të thotë që mentori duhet ta konsiderojë përmbytjen e paraqitur në këtë botim si sugjerime që mund të përshtaten dhe të përdoren për të përbushur sa më mirë objektivat e të nxënës të zhvilluara nga çdo çift mentor-i mentoruar.

## Sesionet e mentorimit

Sesioni 1 është hyrja dhe mund të kombinohet me një sesion tjetër me një temë përmbytësore, të tillë si sesioni 2. Sesioni 10 është përmbledhja dhe vlerësimi përfundimtar. Rekomandohet që në fund të Programit të Mentorimit t’i kushtohet kohë vetëm këtij sesioni. Sesionet përmbytësore 2-9 kanë të bëjnë me tema të ndryshme të prezantuara në manualin e trajnimit dhe kursin HELP mbi aksesin e grave në drejtësi. Më poshtë jepet kronologjikisht lista e sesioneve:

1. Hyrje: të njohim njëri-tjetrin dhe të përcaktojmë objektivat
2. Si lidhet “aksesi i grave në drejtësi” me mua?
3. “Drejtësia është e verbër” nuk do të thotë që është “e verbër në aspektin gjinor”!
4. Të eksplorojmë pengesat lidhur me drejtësinë ndaj grave
5. Aksesin në drejtësi në rastet e dhunës ndaj grave
6. Zbatimi i të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e grave në gjykatat e brendshme
7. Puna me jurisprudencën
8. Çfarë mund të bëhet për të eliminuar stereotipizimin gjinor në proceset gjyqësore?
9. Përdorimi i praktikave të ndjeshme gjinore në jetën reale
10. Mbyllja, vlerësimi dhe hapat pasardhës

## Hartimi i Programit të Mentorimit dhe përshtatja e materialit

I takon mentorit, duke punuar me të mentoruarin, që të zhvillojë një udhërrëfyes për procesin e mentorimit. Matrica e mëposhtme jep udhëzime se si mund të përdoren sesionet, me një përmbledhje të objektivave për çdo sesion dhe të temave kryesore të trajtuara. Jepet numri maksimal i seancave për të mbuluar një program tetë-mujor, por është e mundur që disa seancave t’i kushtohet më shumë kohë se të tjerave. Në varësi të interesave dhe nevojave të identifikuar nga secili i mentoruar, mentori mund të dëshirojë të zgjedhë vetëm pjesë të caktuara të disa sesioneve dhe t’i kombinojë ato në mënyra të ndryshme. Në mënyrë të ngjashme, disa tema mund të zgjerohen në më shumë se një sesion të vetëm, që do të thotë se jo të tetë seancat përmbytësore mund të përdoren në një program tetë-mujor. Megjithatë, programi i plotë i mentorimit duhet të përfshijë sesione që mbulojnë secilin prej niveleve të ndryshme, sikurse përshkruhet në çelësin e sesionit më poshtë (niveli fillestar, i ndërmjetëm dhe i avancuar)).

	Sesionet për orientimet e sesioneve
	Niveli fillestar: të mentoruarit njihen me konceptet kryesore
	Niveli i ndërmjetëm: të mentoruarit punojnë me konceptet që kanë mësuar në kontekste të ndryshme
	Niveli i avancuar: të mentoruarit zbatojnë ato që ata kanë mësuar në përvojën dhe praktikën e tyre

Sesioni	Temat kryesore të trajtuara	Objectives
(1) Hyrje	Mentorimi Nevojat dhe pritshmëritë Objektivat Procesi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Njohja me njëri-tjetrin ndërmjet mentorit dhe të mentoruarve;</li> <li>▶ Eksplorimi i nevojave të të nxënit dhe i fushave të interesave të të mentoruarit;</li> <li>▶ Përcaktimi i objektivave konkrete për procesin e mentorimit</li> </ul>
(2) Si lidhet “aksesi i grave në drejtësi” me mua?	Rishikimi i të dhënave mbi çështjet gjyqësore për të shqyrtuar si/pse gratë i drejtohen sistemit juridik  Rishikimi i të dhënave dhe i informacionit të lidhur me përfaqësimin e grave ndërmjet profesionistëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Prezantimi i temës së aksesit në drejtësi për gratë përmes të dhënave/statistikave</li> <li>▶ I mentoruari identifikon dallimet gjinore dhe trajton arsyet pse gratë përballen me pengesa për të pasur akses në drejtësi</li> <li>▶ Demonstrimi i rëndësisë së temës për profesionin/punën e të mentoruarit dhe për vendin e tij</li> </ul>
(3) “Drejtësia është e verbër” nuk do të thotë që është “e verbër në aspektin gjinor”!	Paanshmëria kundrejt ndjeshmërisë gjinore dhe se si bashkëjetojnë këto dy koncepte në sistemet juridike  Të mësuarit rreth një perspektive të ndjeshme gjinore (“syzet gjinore”)	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ I mentoruari njihet me konceptin e drejtësisë me ndjeshmëri gjinore</li> <li>▶ I mentoruari mëson se kur është e nevojshme një qasje e ndjeshme gjinore në ligj/profesion të së drejtës për të arritur barazi thelbësore</li> <li>▶ Praktikantët e mentorimit duke përdorur “syze gjinore” për të shqyrtuar çështjet hipotetike/kazuset</li> </ul>
(4) Eksplorimi i pengesave ndaj drejtësisë për gratë	Identifikimi i llojeve konkrete të pengesave ndaj drejtësisë për gratë  Reflektim se çfarë masash mund të merren për të lehtësuar ose eliminuar pengesat	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Identifikimi i pengesave të përbashkëta ndaj drejtësisë dhe dallimi i atyre pengesave që kanë ndikim të veçantë mbi gratë</li> <li>▶ Të kuptuarit se si ndërpriten dhe se si mund të ndërthuren pengesa të ndryshme</li> <li>▶ I mentoruari mendon në mënyrë kritike për rolin e tij/saj personal lidhur me trajtimin e pengesave</li> </ul>
(5) Aksesit në drejtësi në çështjet e dhunës ndaj grave	Identifikimi i pengesave të posaçme të lidhura me drejtësinë në çështjet e dhunës ndaj grave duke përdorur ushtrimin “zinxhiri i drejtësisë”  Standardet/detyrimet për rishikim të përfshira në Konventën e Stambollit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Identifikimi i pengesave kritike ndaj drejtësisë për gratë në çështjet penale që lidhen me DNG-në (veçanërisht dhunën në familje).</li> <li>▶ I mentoruari njihet me standardet e Konventës së Stambollit nëpërmjet praktikës duke i zbatuar ato në një kazus</li> <li>▶ Rritja e të kuptuarit të të mentoruarit mbi rëndësinë e trajtimit të pengesave në të gjithë zinxhirin e drejtësisë</li> </ul>
(6) Zbatimi i së drejtës ndërkombëtare lidhur me të drejtat e grave në gjykatat kombëtare	Zbatimi i standardeve ligjore ndërkombëtare në kontekstin kombëtar (si në legjislativonin kryesor dhe në aktet normative)	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ I mentoruari mëson procedurën e citimit të së drejtës ndërkombëtare në kontekstin e brendshëm</li> <li>▶ I mentoruari rishikon standardet ligjore ndërkombëtare që do të ishin më të zbatueshme në çështjet që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të grave</li> </ul>

(7) Puna me jurisprudencën	<p>Puna me çështje për të shqyrtuar se si zbatimi i burimeve të ndryshme të së drejtës mund të çojë në rezultate të ndryshme</p> <p>Praktikimi i zbatimit të standardeve ndërkombëtare në çështjet që kanë të bëjnë me (A) diskriminimin për shkak të seksit/gjinor dhe (B) dhunës kundër grave</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ I mentoruari fiton praktikë duke zbatuar të drejtën kombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare në çështjet e shqyrtuara nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (Komiteti CEDAW)</li> <li>▶ I mentoruari fiton të kuptuarit se si e drejta ndërkombëtare mbulon mangësitë e legjislacionit të brendshëm duke rishikuar skenarët alternativë.</li> </ul>
(8) Çfarë mund të bëhet për të eliminuar stereotipet gjinore në proceset gjyqësore?	<p>Steriotipet gjinore dhe anësia gjinore në çështjet që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave</p> <p>Ndikimi negativ i stereotipeve gjinore sa i takon aksesit të grave në drejtësi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ I mentoruari identifikon stereotipet gjinore, paragjykimet dhe keqkuptimet në lidhje me dhunën ndaj grave nga çështje gjyqësore reale</li> <li>▶ Njohja e dëmit që shkakton stereotipizimi në lidhje me mungesën e aksesit në drejtësi</li> <li>▶ I mentoruari merr parasysh përgjigjet e mundshme nëse ai ose ajo përballet me stereotipe të tilla</li> </ul>
(9) Përdorimi i praktikave të ndjeshme gjinore në jetën reale	<p>Realizimi i një "kontrolli" të punës dhe praktikave profesionale të vetes për të identifikuar pengesa të mundshme të grave për akses në drejtësi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ I mentoruari hedh një vështrim kritik mbi vendin e punës dhe praktikave të veta nga këndvështrimi i një gruaje si përdoruese e drejtësisë</li> <li>▶ Identifikimi i pengesave të mundshme ndaj drejtësisë</li> <li>▶ I mentoruari shqyrton mënyra konkrete për të zbutur pengesat që ai/ajo mund të marrë dhe çfarë mbështetje/burime do t'i nevojiteshin</li> </ul>
(10) Përmbledhje, vlerësimi dhe hapat pasardhës	<p>Përdorimi i formularit përfundimtar të vlerësimit (për të mentoruarit) dhe i raportit përfundimtar të mentorimit (për mentorët), Shtojcat 2 dhe 3.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Rishikimi i procesit të mentorimit dhe i pikave të të nxënies, mësimet e nxjerra nga i mentoruari;</li> <li>▶ Dhënia e komenteve për mentorin/të mentoruarin;</li> <li>▶ Vlerësimi i procesit të mentorimit në aspektin e përmbajtjes dhe metodologjisë;</li> <li>▶ Përcaktimi i hapave të ardhshëm të mundshëm për mësimnxënie dhe zhvillim</li> </ul>

Përshkrimet e sesioneve janë shkruar në mënyrë të përgjithshme, kështu që mentori duhet të shqyrtojë se si përmbajtjen t'ia përshtatë të mentoruarve. Secili sesion përmban këshilla se si mund të përshtatet sesioni për situata të ndryshme mentorimi. Disa këshilla të përgjithshme për të përshtatur materialin që mund të përdoren gjithashtu edhe nga mentori janë:

- ▶ Përdorni të dhëna dhe statistika për situatën kombëtare. Është e dobishme t'i mblidhni të dhënat dhe statistikat paraprakisht ose të identifikoni burimet e këtij informacioni.
- ▶ Jepni shembuj nga konteksti kombëtar; kjo do të kërkonte rishikimin e kërkimeve dhe studimeve ose gjurmimin e çështjeve në lidhje me aksesin në drejtësi që mund të jenë mbuluar nga media (për shembull, çështje "të diskutueshme" të trajtuara në lajme).
- ▶ Kur jepen shembuj të praktikës gjyqësore në një seancë të caktuar, trajtoni çështje në juridiksionin e brendshëm. Kjo do të kërkonte gjetjen e çështjeve që mbulojnë të drejtat e grave dhe përfshijnë pika ose tema mësimore të cilat mund të gjenerojnë një diskutim me të mentoruarin.
- ▶ Kontrolloni nëse Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ose Komiteti CEDAW kanë shqyrtuar çështje nga vendi juaj në lidhje me shkeljet e të drejtave të grave. Këto gjykime/vendime mund të shërbejnë si material për lexim ose për diskutime me të mentoruarit.
- ▶ Përgatitni raste studimore hipotetike/kazuse për të nxitur diskutimin rreth aspekteve konkrete të aksesit të grave në drejtësi (të tilla si pengesa të veçanta, përgjigje të ndryshme të profesionistëve të së drejtës, etj.)



- ▶ Përdorni video për të filluar një diskutim rreth barazisë gjinore, të drejtave të grave ose aksesit në drejtësi për gratë. Agjenci të ndryshme kanë prodhuar videoklipe të shkurtra me mesazhe të thjeshta rreth këtyre temave për audiencën e përgjithshme. Të mentoruarit mund të vlerësojnë nëse këto janë të dobishme/jo të dobishme për ndërgjegjësimin mbi temën e aksesit të grave në drejtësi.

Mbani parasysh që burimet për disa nga këto burime shtesë jepen pas përshkrimeve të sesionit në këtë Ud-hëzues.

Materiali i paraqitur në këtë dokument pasqyron një Program Mentorimi për prokurorë ose gjyqtarë. Mund të jetë me vlerë për mentorët që të eksplorojnë me të mentoruarin fushat konkrete të interesit të të mentoruarit gjatë Sesionit 1. Megjithatë, mentorët mund të duan gjithashtu të planifikojnë se si ta përshtatin materialin për kompetencat e ndryshme të secilit grupi profesionistësh. Aty ku është e mundur, përshkrimet e sesioneve kanë nxjerrë në pah qasje të ndryshme për profesionistët e së drejtës penale dhe civile. Kur planifikoni të bëni mentorimin e prokurorëve ose gjyqtarëve në një kontekst të caktuar të një vendi, mendoni për llojet e temave që lidhen me aksesin e grave në drejtësi që mund të jenë veçanërisht të rëndësishme ose interesante për të mentoruarit, të tilla si: dhuna ndaj grave (e drejta penale dhe procedura penale si dhe përvoja e gjyqtarëve dhe prokurorëve), diskriminimi për shkak të seksit ose gjinisë, ose e drejta familjare (martesa, divorci, të drejtat pronësore).

Mentorimi kërkon angazhimin me të mentoruarit ndryshe nga angazhimi me studentët, dhe mund të jetë e vështirë të mendohen mënyra për të inkurajuar të nxënëit ndëraktiv dhe me përvojë. Disa të mentoruar mund të lidhen me ushtrime dhe metodologji të caktuara më shumë se të tjerët. Më poshtë jepen disa ide për të nxitur ide të mëtejshme se si të angazhohen të mentoruarit. Këto janë “ushtrime përtej ushtrimeve standarde” të cilat të mentoruarit mund t’i bëjnë, t’i shtojnë ose t’i përdorin në vend të ndonjë ushtrimi të përmendur në përshkrimet e sesionit.

- ▶ I mentoruari kryen një intervistë joformale me një gjyqtar (nga një gjykatë ose qytet tjetër) ose me një prokuror (nga një departament ose qytet tjetër) për të zbuluar se si e sheh ai/ajo temën e aksesit të grave në drejtësi, çfarë konsideron si pengesa të grave lidhur me drejtësinë dhe si i kupton të drejtat e grave në praktikën e tyre.
- ▶ I mentoruari shkruan një editorial për publikun e gjerë në lidhje me një çështje aktuale gjyqësore që ka të bëjë me të drejtat e grave (në përputhje me standardet e etikës profesionale, natyrisht, dhe duke mos komentuar çështje specifike ose në pritje të gjykimit).
- ▶ Imagjinoni që i mentoruari punon në një shtet që ka miratuar një mekanizëm të ri ligjor të urdhrave të mbrojtjes për rastet e dhunës në familje (urdhra që largojnë autorin e dhunës nga shtëpia për një periudhë të përkohshme). Detyra e tij është që të hartojë një përmbledhje për një kurs trajnimi për avokatët e ndihmës juridike se si të ndihmojnë gratë që janë viktime të dhunës për të aplikuar për një urdhër mbrojtës. I mentoruari vendos se cilat tema mendojnë se duhet të trajtohen në trajnim dhe përfshin disa pika nën secilën prej tyre. Ai/ajo duhet të përipiqet të parashikojnë se si avokatët mund të rezistojnë ndaj ligjit të ri dhe si t’i përgjigjen argumenteve të tyre.
- ▶ I mentoruari imagjinojë një skenar imagjinar ku sistemi i drejtësisë nuk është kompetencë e shtetit, por është një shërbim tregtar. Dhe përdorueset gra të drejtësisë janë klientë potencial që paguajnë për atë shërbim. I mentoruari harton një reklamë që promovon sistemin e drejtësisë dhe i josh gratë ta përdorin atë. Çfarë tiparesh pozitive do të nxirrin në pah?
- ▶ Të mentoruarit shikojnë disa videoklipe mbi barazinë gjinore (në seksionin Burimet). Ata përcaktojnë disa pika kryesore për një video të thjeshtë që do të shpjegonte aksesin e grave në drejtësi për publikun e gjerë. Cilat tema do të theksoheshin në një fushatë ndërgjegjësimi publik lidhur me këtë temë?

## Organizimi i të mentoruarve

Sesionet e mentorimit mund të organizohen si sesione individuale dhe/ose sesione në grupe në varësi të kontekstit dhe disponueshmërisë së të mentoruarve. Disa prej sesioneve mund të jenë veçanërisht efektive nëse përdoren në një ambient grupi, pasi zakonisht diskutimet dhe nxjerrja e ideve janë më të zjarrta kur ka më shumë këndvështrime. Megjithatë, edhe mentorimi me një individ të veçantë ka avantazhet e veta, pasi në këto raste të mentoruarit i jepet mundësia që të eksplorojë sfida me të cilat ai është përballur në përvojën e tij/saj në më tepër thellësi.



Të mentoruarit duhet të kenë mundësi të kërkojnë sesione individuale, nëse e mendojnë të arsyeshme. Sesionet në grupe mund të perceptohen si mundësi shtesë të të nxëniet përmes kolegëve. Mentori duhet të marrë parasysh stilet e ndryshme të të nxëniet dhe preferencat e të mentoruarve. Kur bëhen sesione në grup, mentori luan gjithashtu rolin e lehtësuesit të takimit, duke u siguruar se të gjithë të mentoruarit kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të kontribuar me mendimet e tyre në proces.

### **Përpara se të fillojë procesi i mentorimit**

Programi i Mentorimit do të ishte veçanërisht efektiv për të mentoruarit të cilët janë prezantuar me konceptin e aksesit të grave në drejtësi përmes metodave të tjera të të nxëniet (të bazuara në klasa, duke përdorur manualin, ose përmes studimit individual në kurset online). Sesionet e Programit të Mentorimit janë hartuar për t'u mbështetur në njohuritë bazë të të mentoruarit lidhur me konceptin e aksesit të grave në drejtësi. Për këtë arsye, të mentoruarit duhet të inkurajohen të rishikojnë kursin HELP për aksesin e grave në drejtësi përpara se të takohen me mentorët e tyre për sesionin e Hyrjes.

Modulet përkatëse të kursit HELP shënohen gjithashtu në secilin prej sesioneve të mentorimit (siç shënohen edhe seksionet përkatëse të manualit të trajnimit) në rast se mentori ose i mentoruari dëshirojnë t'i shqyrtojnë këto materiale. Mentori duhet t'i inkurajojë të mentoruarit që të paktën të regjistrohen dhe ndjekin kursin online në të njëjtën kohë me Programin e Mentorimit<sup>5</sup>.

---

5. Përmbledhja e kursit është e disponueshme këtu: <http://help.elearning.ext.coe.int/pluginfile.php/154365/course/section/27343/HELP%20WAJ%20course%20brief.pdf>. Të mentoruarit mund të krijojnë një llogari dhe të logohen në kurs këtu: <http://help.elearning.ext.coe.int/login>

## Sesioni 1: Hyrje: të njohim njëri-tjetrin dhe të përcaktojmë objektivat

Ky sesion është kontakti i parë midis mentorit dhe të mentoruarit dhe ai është thelbësor pasi hedh themelet për bashkëpunim afatgjatë. Të mentoruarit duhet të jenë në gjendje të kapin idenë e procesit dhe të shohin përfitimet e mentorimit në punën e tyre. Ky sesion duhet gjithashtu të japë kohë për të dyja palët që të njohin njëri-tjetrin në aspektin personal dhe atë profesional.

### Objektivat e të nxënit

Ky sesion ka për qëllim që të përcaktojë kuadrin për procesin e mentorimit dhe për punën e të mentoruarit. Objektivat e tij janë:

- ▶ Të prezantojë Programin e Mentorimit;
- ▶ Të sqarojë qëllimin e mentorimit;
- ▶ Të krijojë kontaktin e parë ndërmjet mentorit dhe të mentoruarit;
- ▶ Të kuptojë nevojat e të nxënit të të mentoruarit përmes diskutimit të kontekstit dhe përcaktimit të objektivave përkatëse të të nxënit.

Diskutimi i rezultateve të pritshme për të mentoruarin është gjithashtu një element që mund të mbështesë planifikimin e një procesi të përshtatshëm. **Përcaktimi i objektivave individuale të të nxënit për të mentoruarin** është objektivi më i rëndësishëm i këtij sesioni.

### Ndikimi i pritshëm

Deri në fund të sesionit, i mentoruari duhet të njihet me konceptin e mentorimit dhe procesin ku është përfshirë. Të mentoruarit duhet të shohin qartë se si ky proces do të mbështesë praktikën e tyre në fushën e drejtësisë.

### Përmbajtja/temat

Prezantimet dhe njohja me njëri-tjetrin

Qëllimi dhe procesi i Programit të Mentorimit

Nevojat e të nxënit dhe objektivat individuale

Marrëveshje për kushtet e bashkëpunimit midis mentorit dhe të mentoruarit.

### Ushtrime

Mentori mund të përdorë mjete të tilla si kartat e vlerës për të eksploruar praktikën profesionale të të mentoruarit ose për të eksploruar përmes tregimit me gojë të çështjeve dhe ideve më të rëndësishme që ka përjetuar i mentoruari në praktikën e tij/saj për sa i përket barazisë gjinore dhe aksesit të grave në drejtësi. Fjalitë e papërfunduara të përgatitura nga mentori mund të ndihmojnë gjithashtu për fillimin e diskutimit rreth përvajave, të tilla si: "Ajo që unë e shoh si më problematike në lidhje me gjininë është ...", ose "Të drejtat e grave në vendin tonë ..."

Për sa i përket identifikimit të nevojave të të nxënit dhe përcaktimit të objektivave të të nxënit, objektivat e Programit të Mentorimit mund të vizualizohen dhe i mentoruari mund t'i prioritetizojë ato në bazë të nivelit të përvajës që ai/ajo mendon se ka në lidhje me secilën temë.

### Fushat për diskutim

Në këtë sesion ia vlen të eksplorohej përvoja profesionale dhe historiku i të mentoruarit, dhe lidhja e tyre me temën e barazisë gjinore dhe aksesit të grave në drejtësi. Në thelb, ky është sesioni ku mentori duhet të mbledhë të dhëna në mënyrë që të jetë në gjendje të përshtatë procesin e mentorimit me nevojat e të mentoruarit. Të gjitha pyetjet që lidhen me procesin dhe kornizën e trajnimit duhet të lejohen dhe të sqarohen gjatë këtij sesioni.

## Burime

Formulari i raportimit të sesionit – fleta e të dhënave që duhet të plotësohet nga mentori pas çdo seancë (përdorni formularin e sesionit të mentorimit (për mentorët) të dhënë në Shtojcën 1).

## Sesioni 2: Si lidhet “aksesi i grave në drejtësi” me mua?

Ky sesion synon të “thyejë akullin” dhe të familjarizojë të mentoruarin/të mentoruarit me konceptin e aksesit të grave në drejtësi. Sesioni i inkurajon të mentoruarit të mendojnë se si kjo temë lidhet me përvojat e tyre. Sesioni është menduar të përdoret në fillim të Programit të Mentorimit, por ai mund të përshtatet për përdorim deri në fund, në mënyrë që të tërheqë vëmendjen e të mentoruarve se si mund ta zbatojnë atë që kanë mësuar në punën e tyre.

### Përkon me

Ky sesion përdor material nga manuali i trajnimit mbi aksesin e grave në drejtësi (veçanërisht, nga Hyrja dhe seksioni 4.13), i cili përdoret gjithashtu në kursin HELP për Aksesin e Grave në Drejtësi (Modulet 1 dhe 3).

### Objektivat e të nxënit

I mentoruari angazhohet në temën e aksesit të grave në drejtësi duke pranuar se kjo është në çështje e rëndësishme për të gjitha sistemet ligjore.

Që në fillim të programit, i mentoruar mëson se qasja e grave në drejtësi nuk është thjesht një koncept abstrakt, por është një problem që ekziston në juridiksionin e saj/të tij.

### Ndikimi i pritshëm

I mentoruari do të kuptojë rëndësinë e temës së aksesit të grave në drejtësi, si dhe zbatimin praktik të kursit dhe Programit të Mentorimit në jetën e saj/tij profesionale. I mentoruari duhet të jetë entuziast për temën dhe duhet të jetë i angazhuar për të vazhduar më tej me programin.

### Përmbajtja/temat

- a. Shqyrtimi i të dhënave mbi përdorimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nga gratë.

Në vitin 2007, Françoise Tulkens (ish gjyqtare dhe Zëvendës Kryetare e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) bëri një studim mbi çështjet e dërguara në Gjykatë. Ajo konstatoi se 16% e çështjeve ishin dorëzuar nga gratë. Gjyqtare Tulkens arriti në përfundimin se të dhënat sugjerojnë se mund të jetë më e vështirë për gratë që të dorëzojnë çështje në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke nënkuptuar se aksesin e tyre në drejtësi është disi i komprometuar.

- b. Shqyrtimi i të dhënave mbi përfaqësimin e grave në profesionet e së drejtës.

Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë i Këshillit të Evropës (CEPEJ) vlerëson në mënyrë të rregullt efikasitetin e sistemeve gjyqësore të shteteve anëtare. Vlerësimet përfshijnë edhe indikatorë të barazisë gjinore. Në vitin 2016, gratë përfaqësonin 59% të të gjithë gjyqtarëve profesionistë të shkallës së parë, por vetëm 36% të kryetarëve të gjykatave në këtë nivel. Gjithashtu, 51% e prokurorëve ishin gra, por vetëm 34% e kryeprokurorëve ishin gra. Mbani parasysh se në vitin 2020, CEPEJ do të shtojë shifra të lidhura me vitin 2018 në bazën e saj të të dhënave.

- c. Analizimi i të dhënave kombëtare mbi numrin dhe përqindjen e çështjeve të depozituara nga gratë si dhe përfaqësimi i femrave në profesionet ligjore. Mentori mund të kërkojë që të mentoruarit të shpenzojnë ca kohë përpara këtij sesioni për të kërkuar për llojet e të dhënave që janë të disponueshme në juridiksionet e tyre.

### Ushtrime

- a. Të mentoruarit mund të japin një fragment të studimit të Gjykatës Tulkens për t’u diskutuar gjatë seancës, ose mentori mund të kërkojë që ata të lexojnë të gjithë artikullin si punë përgatitore për seancën.
- b. Të mentoruarve mund t’u kërkohet që të njihen me bazën e të dhënave të CEPEJ-it mbi sistemet gjyqësore evropiane dhe, më konkretisht, që të gjejnë të dhëna lidhur me përfaqësimin e grave në

profesione të ndryshme ligjore në vendin e tyre. Të mentoruarit duhet të inkurajohen që të eksplorojnë më tej bazën e të dhënave dhe të krahasojnë të dhëna nga profesione dhe vende të ndryshme.

- c. Ose si detyrë përgatitore për sesionin, ose si punë plotësuese të lidhur me të, të mentoruarit mund të përpiqen të gjejnë të dhëna shtesë kombëtare për të plotësuar panoramën se si gratë e përdorin sistemin ligjor (në veçanti gjykatat) dhe se si përfaqësohen ata në sistemin kombëtar ligjor. Ka të ngjarë që këto të dhëna të mos jenë të disponueshme, kështu që mentori duhet ta inkurajojë të mentoruarin të përdorë njohurinë dhe përvojën e tij/saj dhe t'i mbajë parasysh këto çështje gjatë të gjithë programit dhe të mbajnë shënim çdo gjë që ata mësojnë/vëzhgojnë

## Fusha për diskutim

(a)

- ▶ Duke pasur parasysh se gratë përfaqësojnë të paktën gjysmën e popullsisë së Evropës, cilat mund të jenë disa shpjegime për faktin se më pak se një e katërta e çështjeve në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut janë depozituar nga gratë?
- ▶ Pyeteni të mentoruarin tuaj se cilat janë fushat kryesore të së drejtës ose shkeljet më të zakonshme të të drejtave të njeriut për të cilat gratë i drejtohen Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, bazuar në njohuritë dhe përvojën e tij/sa. Mbani parasysh se vetë Gjykata nuk boton të dhëna të ndara sipas gjinisë për aplikantët apo çështjet e shqyrtuara. A do të ishte mirë të kishim të dhëna të tilla? Pse ose pse jo?

(b)

- ▶ Çfarë modelesh identifikoni ju (i mentoruari) lidhur me të dhënat e CEPEJ-it mbi përfaqësimin e grave në profesionet ligjore, duke menduar për dallimet brenda një profesioni të vetëm (p.sh. gjyqtarë, prokurorë), midis profesioneve dhe midis vendeve të ndryshme? Cilat mund të jenë disa shpjegime për dallimet, veçanërisht për të shpjeguar fenomenin që njihet si “pengesë e padukshme” për gratë?
- ▶ Si lidhet përfaqësimi i grave si prokurore apo gjyqtare me konceptin e “aksesit të grave në drejtësi”?
- ▶ Çfarë lidhje ka, nëse ka, me gjetjet për gratë që kanë dorëzuar çështje në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe përfaqësimin e grave në sistemet e drejtësisë? Duke menduar në kontekstin e gjerë, cilat janë disa nga mënyrat se si mund t'i mbështesim gratë në sektorin e drejtësisë?

(c)

- ▶ Çfarë të dhënash janë të disponueshme në sistemin tuaj të brendshëm ligjor? Sa çështje (dhe %) janë paraqitur nga gratë? Në cilat fusha të së drejtës paraqiten më shpesh çështje gratë? A i dorëzojnë në emër të tyre, apo në emër të të tjerëve çështjet gratë?
- ▶ Nëse nuk ka të dhëna të disponueshme, si e shihni panoramën e përgjithshme të grave përdoruese të drejtësisë, bazuar në përvojën tuaj profesionale?
- ▶ Çfarë lloj të dhënash apo informacionesh nevojiten për të sqaruar më tej se ku mund të ketë mangësi apo akses të pabarabartë në drejtësi për gratë? Cilat janë disa burime të mundshme të këtij informacioni që i mentoruari mund të ketë parasysh kur merr pjesë në këtë program?
- ▶ A keni menduar më parë për dallimet lidhur me mënyrën se si gratë dhe burrat përdorin ose përfaqësohen në sistemin ligjor kombëtar? Pse ose pse jo?

## Këshilla për përshtatje

- ▶ Për prokurorët mund të jetë e dobishme që të krahasojnë të dhënat për viktimat/të pandehurit femra dhe meshkuj në çështjet penale. Çfarë modelesh shohin ata në format e dhunës që prekin në mënyrë jopërpjestimore gratë? Çfarë sugjerojnë modelet?
- ▶ Është e mundur që të mentoruarit të mos jenë shumë të njohur me konceptin e hendeqeve gjinore ose pabarazive gjinore. Mund të jetë e dobishme të kemi një diskutim më të gjerë rreth pabarazive

përtej sistemit ligjor, duke parë si kontekstin kombëtar ashtu edhe në modelet që shihen globalisht. Ky diskutim mund të përfshijë çështje të tilla si pabarazinë e pagave, “ndarjen” sipas llojeve të punëve të kryera nga gratë dhe burrat, përfaqësimin e grave në zyrat politike, etj. Të mentoruarit mund të mendojnë se si modelet të tilla pabarazie lidhen me temën e aksesit të grave në drejtësi. [Shënim: kjo temë lidhet gjithashtu me sesionin 4 për “eksplorimin e barrierave ndaj drejtësisë për gratë”].

## Burime

*Të drejtat e njeriut, të drejtat e grave. Aplikantet femra në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.* Ligjëratë e mbajtur nga Françoise Tulkens (2007).  
<https://rm.coe.int/1680597b21>

Paneli i CEPEJ-it për Barazinë Gjinore në gjykata dhe në shërbimet e prokurorisë publike  
[https://public.tableau.com/profile/cepej#!/vizhome/CEPEJ-Genderequalityv1\\_3/Barcharts](https://public.tableau.com/profile/cepej#!/vizhome/CEPEJ-Genderequalityv1_3/Barcharts)  
<https://www.coe.int/en/web/cepej/dynamic-database-of-european-judicial-systems>

Shënim: mund të jetë e dobishme të rishikohen gjashtë komponentët thelbësorë të aksesit të grave në drejtësi siç ato janë artikuluar nga Komiteti CEDAW në rekomandimin e përgjithshëm nr. 33 mbi aksesin e grave në drejtësi, Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave (2015)  
[https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/GC/33&Lang=en](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/GC/33&Lang=en)

Gjashtë komponentët thelbësorë për aksesin e grave në drejtësi përmbledhen gjithashtu në seksionin 1.1.2 të *Manualit të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët mbi Sigurimin e Aksesit të Grave në Drejtësi* dhe në Modulin 1 të kursit HELP).

## ***Sesioni 3: “Drejtësia është e verbër” nuk do të thotë “e verbër në aspektin gjinor”!***

Qëllimi i këtij sesioni është të sigurojë që i mentoruari të kuptojë se çfarë është perspektiva gjinore dhe, për më tepër, pse është e dobishme për prokurorët dhe gjyqtarët që të marrin parasysh aspektin gjinor..

### **Përkon me**

Materiali përkon me Kreun 1 (seksioni 1.1) dhe Kreun 4 (veçanërisht seksionin 4.8) të *Manualit të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët mbi Sigurimin e Aksesit të Grave në Drejtësi* dhe Modulet 1 dhe 5 të kursit HELP për Aksesin e Grave në Drejtësi.

Mbani parasysh se një sesion tjetër (sesioni 9) shtjellon më tej idetë e drejtësisë me ndjeshmëri gjinore dhe angazhon të mentoruarin në një mënyrë më proaktive për të identifikuar ndryshimet që ata mund të bëjnë në praktikën e tyre. Sesioni 9 është projektuar për t’u përdorur në fund të Programit të Mentorimit. Ky sesion (3) synon të prezantojë një koncept të rëndësishëm që do të pasqyrohet në sesionet e mëvonshme. Megjithatë, është e mundur të kombinohen sesionet 3 dhe 9 si një ushtrim i vetëm mësimor.

### **Objektivat e të nxënit**

I mentoruari do të kuptojë se koncepti i drejtësisë “së verbër” (paanshmëria) nuk do të thotë se nuk duhet bërë kurrë dallime midis grave dhe burrave për sa i përket drejtësisë. I mentoruari duhet të mësojë kur ka arsye legjitime për trajtimin e grave dhe burrave ndryshe (në ligj dhe në proceset gjyqësore). Sesioni do të ndihmojë të mentoruarin të njohë dallimin ndërmjet barazisë formale ose juridike (d.m.th., asaj që shkruhet në ligj) dhe barazisë materiale (barazia e rezultateve dhe barazia e mundësive) dhe se në mënyrë që gratë të jenë në gjendje të kenë akses në drejtësi, duhet t’i kushtohet vëmendje barazisë materiale të grave (mbani parasysh se konceptet e barazisë formale dhe materiale janë shtjelluar më në hollësi në Modulin 3 të kursit HELP).

### **Ndikimi i pritshëm**

I mentoruari do të jetë në gjendje të dallojë kur dhe pse është e përshtatshme t’i kushtohet vëmendje e veçantë çështjeve gjinore (dhe pabarazive që përjetojnë gratë) brenda sistemeve ligjore që mbështesin parimet e paanësisë. Të kuptuarit se çfarë është perspektiva gjinore dhe si të zbatohet ajo kur punoni brenda sistemit ligjor është themeli për përmirësimin e aksesit të grave në drejtësi. Koncepti i “drejtësisë së ndjeshme gjinore” mbështet gjithashtu në manualin e trajnimit dhe kursin online. Së fundi, ky sesion duhet ta ndihmojë të mentoruarin të përvetësojë konceptin e perspektivës gjinore dhe t’i japë atij/asaj besimin për të filluar të bëjë ndryshime në praktikën e tij/saj (një detyrë që përforcohet në Sesionin 9).

### **Përmbajtja/temat**

- a. Njohja e asaj që e bën problematike qasjen e verbër gjinore dhe praktikimi i transformimit të saj në një qasje të ndjeshme gjinore.
- b. Reflektimi mbi dispozitat e barazisë gjinore në legjisllacionin kombëtar krahasuar me situatën *de facto* në vend, me qëllim përmirësimin e të kuptuarit se si statusi i pabarabartë i grave mund të ndikojë në aksesin e tyre në drejtësi.

### **Ushtrime**

- a. Të mentoruarit duhet të marrin parasysh situatat e mëposhtme dhe qasjet e mundshme që mund të përdoren. Mbani parasysh se mentori dhe i mentoruari mund të rishikojnë të tre kazuset ose mentori mund të dëshirojë të zgjedhë ato që janë më të rëndësishmet për të mentoruarin. Si hap tjetër, mentori mund të prezantojë kazuse shtesë që përputhen me interesat e të mentoruarit ose me historikun profesional të tij/saj.

### Kazusi 1 (krahasoni kazuset)

Ana shkon në komisariat për të denoncuar bashkëshortin e saj. Ajo thotë se bashkëshorti i saj prej vitesh e ka dhunuar atë fizikisht dhe emocionalisht. Një natë më parë ai e akuzoi Anën se ajo kishte një lidhje me një koleg mashkull. I ka marrë në mënyrë agresive celularin dhe nuk ka pranuar ta kthejë. Kur Ana u përpoq t'ia merrte telefonin, burri i saj e shtyu dhe ajo u përplas me tavolinën. Në pjesën e sipërme të krahut ajo ka një mavijosje të madhe të dukshme.

Barbara shkon në komisariat për të bërë një denoncim për një grabitje. Një natë më parë kur ajo po kthehej në shtëpi nga stacioni i trenit, një burrë i kishte shkuar nga pas dhe i kishte marrë celularin nga dora. Ajo nuk e ka idenë se kush ishte burri, por mund të identifikojë disa tipare të tij. Ajo u përpoq të mos e lëshonte telefonin, por u shty përtokë gjatë përlshjes. Në pjesën e sipërme të krahut ka një mavijosje të madhe të dukshme.

### Kazusi 2

Një prokuror publik aktualisht po punon me një çështje që ka të bëjë me dhunë seksuale. Viktima, personi C, thotë se është përdhunuar në një festë. Ekzistojnë prova mjeko-ligjore se si C-ja ashtu edhe i akuzuari ishin të dehur në atë kohë. Prokurori e intervistoi C-në dy herë dhe tani, tre muaj pas takimit të mëparshëm, e thërret për intervistë shtesë. Në këtë intervistë, C-ja është e shqetësuar për faktin se në internet qarkullon një video që tregon të akuzuarin duke kryer një akt seksual ndaj C-së. Ajo u jep përgjigje të paqarta pyetjeve të prokurorit, duket se ka mangësi në kujtesë dhe bën disa deklaratë që kundërshtojnë rrëfimin e saj të mëparshëm për ngjarjet. Prokurori vendos të pushojë çështjen për shkak të dyshimeve lidhur me besueshmërinë e viktimës dhe mungesës së provave të qarta.

### Kazusi 3

Në një çështje divorci, ish-bashkëshorti pretendon pronësi të vetme të një biznesi familjar. Gjykata merr parasysh historikun e punësimit të ish-bashkëshortit, të ardhurat dhe blerjen e pasurive, si dhe faktin që ish-bashkëshortja ka dhënë kontribute të kufizuara financiare për të mbajtur familjen ose biznesin. Ish-bashkëshorti ishte i punësuar me kohë të plotë gjatë gjithë martesës. Ish-bashkëshortja punonte me kohë të pjesshme si kontabiliste për biznesin për disa vite, por kishte edhe periudha papunësie kur fëmijët e çiftit ishin të vegjël dhe kur kujdesej për prindërit e saj të moshuar. Vlera e pasurive martesore të kombinuara, përfshirë biznesin, vlerësohet në mbi 5.6 milionë euro. Gjyqtari përcakton nevojat financiare të ish-bashkëshortes me 110 000 euro dhe vendos për dhënie të kësaj shume si shumë e përgjithshme. Pjesën e mbetur të pronës ia lë ish-bashkëshortit.

- b. I mentoruari duhet të rishikojë dispozitat e barazisë dhe mosdiskriminimit në legjislacionin e brendshëm (ky mund të jetë legjislacioni i brendshëm që përcakton barazinë midis grave dhe burrave ose ligje që ndalojnë diskriminimin për shkak të seksit ose me bazë gjinore). Më pas, i mentoruari reflekton mbi dallimet midis barazisë formale (de jure) dhe barazisë materiale duke marrë parasysh se cilët janë shembujt më të qartë të pabarazisë ose diskriminimit ndaj grave në shoqërinë e tij/saj (d.m.th. dallimet në paga, rolet gjinore, dhuna ndaj grave, etj.).

## Fusha për diskutim

(a)

- ▶ Në kazusin 1 (Ana dhe Barbara), cilat janë fushat e ngjashmërisë për sa i përket legjislacionit përkatës dhe përgjigjeve të mundshme të organet e zbatimit të ligjit (ose profesionistëve të tjerë të së drejtës)? Cilat janë ndryshimet kryesore dhe çfarë sugjerojnë dallimet për sa i përket një përgjigjeje ligjore? Imagjinoni rezultatet e mundshme nëse të dyja incidentet do të trajtoheshin në thelb në të njëjtën mënyrë ose nëse do të trajtoheshin ndryshe? Cilat mund të jenë pasojat negative dhe pozitive të zbatimit të së njëjtës qasje ose qasjeve të ndryshme? Çfarë duhet të përfshihet në qasjen e ndjeshme gjinore?
- ▶ Në kazusin 2 (rasti C), reflektoni mbi veprimet dhe vendimet e prokurorit që mund të jenë problematike dhe nuk janë të ndjeshme në aspektin gjinor. Çfarë i bën ata "të verbër në aspektin gjinor"? Cilat janë disa mënyra që prokurori mund të kishte përdorur prokurori për t'ju qasur ndryshe që do të kishin qenë më të përgjegjshme ndaj situatës dhe përvojave të viktimës?



- ▶ Në kazusin 3 (çështja e divorcit), a mendoni se vendimi i gjyqtarit do të nxiste barazi apo pabarazi për sa i përket rezultateve? Si u vlerësuan kontributet e dhëna nga burri dhe gruaja? Nëse kontributet jofinanciare të grave (p.sh. rritja e fëmijëve, kujdesi për anëtarët e familjes dhe kryerja e detyrave të shtëpisë) nuk vlerësohen në të njëjtën masë si kontributet financiare, cili është rezultati në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të grave? A ju duket e drejta civile/vendimi gjyqësor diskriminues apo i verbër në aspektin gjinor në këtë kazus? Shpjegoni arsyen pse.

(b)

- ▶ Cilët janë disa shembuj të pabarazive gjinore në vendin tuaj? Cilët janë faktorët strukturorë që mbështesin këto pabarazi ose që çojnë në diskriminim për shkak të seksit/gjinisë?
- ▶ Mendoni se si diskriminimi dhe pabarazia mund të kenë ndikim mbi rezultatet e një procesi gjyqësor. Mendoni për shembuj se si pritshmëritë shoqërore për gratë/burrat, rolet gjinore dhe stereotipet mund të pasqyrohen në procese gjyqësore në një mënyrë që çon në rezultate të pabarabarta. Çfarë nevojitet të korrigohet në situata të tilla?
- ▶ Ndjeshmëri gjinore do të thotë të pranosh ekzistencën e hendeqeve gjinore dhe të pabarazive strukturorë dhe të jesh i ndjeshëm ndaj nevojave të ndryshme të grave dhe burrave në sistemet ligjore. A mund të kujtoni ndonjë shembull të vendimmarrjes me ndjeshmëri gjinore nga përvoja juaj personale ose nga vendimet e gjykatave me të cilat jeni njohur?
- ▶ Sipas jush, a është sfidë aplikimi i qasjes të ndjeshme gjinore në punën tuaj profesionale? Dhe nëse po, pse, dhe çfarë paraqet konkretisht sfidat më të mëdha?

## Këshilla për përshtatje

- ▶ Ky sesion mund të zhvillohet si vetë-reflektim i udhëhequr ndërmjet mentorit dhe të mentoruarit, ose mund të jetë vlerë që të mbahet një diskutim në grup që përfshin disa të mentoruar në mënyrë që të përfshihen mendime dhe sugjerime të ndryshme.
- ▶ Diskutimi rreth pabarazive gjinore në pjesën b mund të vijojë nga sesioni 2. Nëse i mentoruari ka vështirësi të identifikojë pabarazitë gjinore që ekzistojnë në vend ose shpreh mosbesim lidhur me praninë e fushave të pabarazisë midis grave dhe burrave, do të ishte e dobishme për mentori të përgatitet paraprakisht dhe të ketë të dhëna dhe kërkime në dispozicion për t'i rishikuar së bashku me të mentoruarin.
- ▶ Nëse një i mentoruar e ka të vështirë të konceptojë se çfarë nënkuptohet me zbatimin e perspektivës gjinore ose të jesh i ndjeshëm në aspektin gjinor, mund të jetë e vlefshme të përdoret metafora e vendosjes së "syzeve gjinore". Kjo është një frazë e shpikur nga Ministria e Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë e Finlandës për të përshkruar procesin e shqyrtimit aktiv të legjislacionit, vendimmarrjes, programeve, projekteve, etj. për të parë nëse ato mund të prekin gratë dhe burrat ndryshe nga perspektiva gjinore. Pyeteni të mentoruarin se cilat janë ndryshimet në nevojat dhe prioritetet e grave dhe burrave? "Syze gjinore" do të thotë që të përdorësh një perspektivë të re për të parë gjërat e njohura.

## Burime

Nëse të mentoruarit e kanë të vështirë të identifikojnë fushat ku gratë përballen me diskriminim në vendin e tyre, materialet më poshtë mund të ofrojnë informacion shtesë:

Studime të vendeve të Këshillit të Evropës mbi pengesat, mjetet juridike dhe praktikat e mira për aksesin e grave në drejtësi për vendet e mëposhtme: Armenia, Azerbajxhani, Gjeorgjia, Republika e Moldavisë dhe Ukraina  
[https://www.coe.int/en/web/genderequality/equal-access-of-women-to-justice#{"14965347":\[0\]}](https://www.coe.int/en/web/genderequality/equal-access-of-women-to-justice#{)

Raportet e shteteve dhe vëzhgimet përfundimtare të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave  
<https://www.ohchr.org/en/hrbodies/cedaw/pages/cedawindex.aspx>  
 (kërkoni informacionin sipas vendeve)

## Sesioni 4: Eksplorimi i pengesave të aksesit të grave në drejtësi

---

Ky sesion synon të inkurajojë të mentoruarit që të marrin parasysh pengesat ndaj drejtësisë me të cilat hasen gratë në një mënyrë më konkrete dhe më pak abstrakte dhe të identifikojnë pengesat më kritike për gratë në vendin/juridiksionin e tyre.

### Përkon me

Materiali përkon me Kreun 1, seksioni 1.1, të *Manualit të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët mbi Sigurimin e Aksesit të Grave në Drejtësi* dhe Modullit 1 të kursit HELP.

### Objektivat e të nxënit

I mentoruari merr parasysh pengesat e përbashkëta për aksesin në drejtësi dhe është në gjendje të bëjë dallimin midis pengesave që u përkasin të gjithë përdoruesve të drejtësisë, atyre që prekin vetëm gratë dhe atyre që kanë një ndikim veçanërisht negativ mbi gratë. Për më tepër, të mentoruarit duhet të kuptojnë se si kryqëzohen pengesat ligjore dhe institucionale dhe pengesat social-ekonomike dhe kulturore për gratë.

### Ndikimi i pritshëm

Të mentoruarit do të jenë në gjendje të identifikojnë pengesat konkrete të lidhura me aksesin e grave në drejtësi që janë karakteristike për vendin dhe sistemin e tyre ligjor. Pas kësaj, i mentoruari duhet të planifikojë veprime konkrete që mund të ndërmerren në praktikën e veta, të cilat mund të zbusin disa nga këto pengesa, duke parë konkretisht fushën e së drejtës në të cilën ata punojnë. Të mentoruarit duhet të vlerësojnë faktin se profesionistët e së drejtës mund të ndërmerren gjithashtu hapa për të ulur ndikimin e pengesave social-ekonomike dhe kulturore duke mos i eliminuar domosdoshmërisht këto pengesa.

### Përmbajtja/temat

- a. Duke punuar në mënyrë të pavarur, i mentoruari mund të reflektojë mbi praktikën e tij/saj dhe të zhvillojë një listë të: (i) pengesave ligjore dhe institucionale; dhe (ii) pengesave social-ekonomike dhe kulturore që janë të përhapura në sistemet përkatëse ligjore. Ata mund të reflektojnë mbi ndikimin e këtyre pengesave mbi gratë dhe burrat. Ky ushtrim mund të bëhet edhe në grup si një lloj ushtrimi për të nxjerrë ide. Përndryshe, mentori mund të japë një listë të hapur të pengesave (shembuj), mbi të cilat i mentoruari, ose grupi i të mentoruarve, do të reflektojë dhe do të shtojë dhe pengesa të tjera.
- b. Pas kategorizimit dhe diskutimit më në shumë detaje të pengesave kryesore ndaj drejtësisë, i mentoruari ose grupi i të mentoruarve duhet të udhëzohen të shqyrtojnë se çfarë veprimesh mund të ndërmerren ata personalisht për të zbutur pengesat ndaj grave lidhur me aksesin në drejtësi.

### Ushtrime

- a. Të mentoruarit mund të njihen me grafikun e mëposhtëm që paraqet mënyra të ndryshme të kategorizimit të pengesave ndaj drejtësisë dhe të diskutojnë nëse ai pasqyron përvojat e tyre apo jo.



Më pas, mentori mund t'u japë të mentoruarve një listë të hapur të pengesave të përbashkëta ndaj aksesit në drejtësi dhe ata mund të diskutojnë se në cilën kategori duhet të vendosen (si dhe nëse ato konsiderohen si pengesa ligjore, institucionale, social-ekonomike apo kulturore). Të mentoruarit duhet të inkurajohen të "shpaketojnë" çfarë përfshihet në këto pengesa dhe pse ato paraqesin probleme, pasi shumë shpesh ato nuk përshtaten mirë në një kategori të vetme. Është më e rëndësishme që të mentoruarit të marrin parasysh se çfarë përfshihet në secilën pengesë më shumë sesa ta kategorizojnë atë.

Burime të kufizuara financiare (përveç kësaj, tarifa të larta ligjore)  
 Nën-përfaqësimi i grave në profesionet e së drejtës  
 Legjislacioni diskriminues  
 Mosbesimi ndaj institucioneve ligjore  
 Niveli i ulët i arsimimit (d.m.th. mungesa e vetëdijes për të drejtat ligjore të dikujt)  
 Mangësitë në legjislacion (d.m.th. shkeljet e të drejtave të njeriut që nuk trajtohen me ligj)  
 Stereotipizimi gjinor  
 Trajnim i kufizuar për profesionistët e së drejtës (për shembull, mbi dhunën ndaj grave)  
 Statusi i pakicave  
 Infrastruktura e paarritshme (p.sh. ndërtesa gjykatash pa rampa, mungesa e materialeve për personat me probleme në shikim, etj.)  
 Korrupsioni (d.m.th. mungesa e llogaridhënies)  
 Barra e pabarabartë e kujdesit (p.sh. përgjegjësitë e kujdesit ndaj fëmijëve)  
 ....

- b. Të mentoruarit mund të hartojnë një tabelë ose listë kontrolli ku të hedhin mendimet e tyre se si mund të jenë në gjendje të trajtojnë pengesat që kanë ndikim të veçantë mbi gratë, pengesa të cilat ata i kanë identifikuar si veçanërisht të rëndësishme. Ata duhet të inkurajohen të jenë strategjikë në atë që mund të bëjnë, por gjithashtu të shikojnë përtej pengesave ligjore dhe institucionale dhe të mendojnë për marrjen e një roli proaktiv. Kategoritë e mostrave përfshihen më poshtë.

### Lista e kontrollit:

Çfarë mund të bëhet menjëherë në punën time? (këto janë zgjidhje afatshkurtra)

- ▶ Të hartohen dhe shpërndahen buletine informative për të drejtat ligjore në zyrën time
- ▶ Të pyeten palët ndërgjyqëse (viktimat, dëshmitarët) nëse ata kanë bërë marrëveshje për kujdesin e fëmijëve përpara se të caktojnë takime ose seanca
- ▶ Të jeni në dijeni dhe të përmbaheni nga mbështetja te stereotipet gjinore

Me çfarë mund të punoj me profesionistë të tjerë të së drejtës? (këto kërkojnë një angazhim më afatgjatë)

- ▶ Hartimi i kurseve të vazhdueshme trajnimi ligjor që mbulojnë çështjet e të drejtave të grave
- ▶ Rishikimi i praktikave të rekrutimit, punësimit dhe promovimit brenda institucionit tim (duke përdorur perspektivën gjinore/"syzet gjinore")
- ▶ Të bëheni mentor dhe të promovoni ndjeshmërinë gjinore

Si mund të jap përvojën time? (këto aktivitete mund të kryhen në një kuadër më afatgjatë)

- ▶ Përmes mbështetjes së zgjerimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas (d.m.th. përfshirjes së viktimave të dhunës në familje)
- ▶ Përmes punës brenda shoqatave vendore të avokatëve ose organizatave të tjera, për të nxjerrë në pah rezultatet pozitive gjyqësore, transparencën dhe efektivitetin e sistemit ligjor
- ▶ Përmes punës me median për të përmirësuar të kuptuarit e publikut se si sistemi ligjor mund të mbrojë të drejtat e grave

.....

### Fusha për diskutim

- a. Cilat janë arsyet më të zakonshme që njerëzit nuk i drejtohen sistemit të drejtësisë kur u shkelen të drejtat? A ka arsye të ndryshme për gratë dhe burrat?

Duke iu referuar materialit (nga manuali i trajnimit ose kursi online HELP), cilat (i) pengesa ligjore dhe institucionale dhe (ii) pengesa social-ekonomike dhe kulturore shihni në sistemin ligjor ku punoni? (bëni një listë). Duke parë këtë listë, a janë disa pengesa më të zakonshme për gratë, ose a kanë ato një ndikim veçanërisht negativ tek gratë? Kaloni pak kohë duke parë më në thellësi për të shqyrtuar se si një fushë e caktuar e pabarazisë do të ndikojë përfundimisht mbi aksesin në drejtësi (d.m.th. nëse gratë marrin përsipër barrën më të madhe të kujdesit ndaj fëmijëve, cili është ndikimi mbi kohën kur mund të shkojnë në gjykatë ose të takohen me një prokuror? Vendimin për të ndjekur një çështje divorci apo për të bashkëpunuar për ndjekjen penale të dhunës në familje?)

A ka pengesa të caktuara për drejtësinë për gratë që vërehen më shpesh në çështjet penale sesa në çështjet civile? Po në lidhje me fushat e tjera të së drejtës (p.sh. e drejta administrative, e drejta familjare)? Diskutoni ndikimet e mundshme të një pengese të veçantë (d.m.th. mungesa e "shkollimit juridik"/njohuri për të drejtat e dikujt).

- b. Duke marrë parasysh pengesat e ndryshme që keni identifikuar për gratë, çfarë mendoni se nevojitet për të eliminuar këto pengesa ose të paktën për të pakësuar ndikimin e tyre (rrihni mendime ose diskutoni nëse jeni në një mjedis në grup)?

A shihni ndonjë model në llojet e përgjigjeve që nevojiten?

Ku shihni një rol të mundshëm për veten tuaj për të ndihmuar për të zbutur ndonjë prej këtyre pengesave?

Mbani parasysh se mentori duhet t'i inkurajojë të mentoruarit që të mendojnë në mënyrë strategjike për atë që mund të jenë në gjendje të bëjnë në kuadrin afatshkurtër dhe ku mund të bëhen më aktivë brenda profesioneve të tyre në kuadrin afatmesëm dhe të ushtrojnë ndikim në ndryshimin afatgjatë. Mund të jetë e dobishme të inkurajohen të mentoruarit të bëjnë një tabelë ku mund të kategorizojnë angazhimet/ndryshimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata që mund të bëjnë.

## Këshilla për përshtatje

- ▶ Ky sesion mund të përdoret në mënyrë efektive si diskutim në grup midis mentorit dhe disa të mentoruarve, si mënyrë për të nxjerrë në pah këndvështrime të ndryshme mbi ndikimin e pengesave të veçanta mbi gratë dhe burrat. Mund të përfshihet edhe një rrahje joformale idesh lidhur me çfarë mund të bëhet për të përmirësuar sistemin e drejtësisë për gratë. Nëse të mentoruarit përfaqësojnë fusha të ndryshme të së drejtës (civile dhe penale), diskutimi do të pasurohej. Por edhe nëse nuk është kështu, mentori mund të shtrojë pyetje në lidhje me fusha të ndryshme të praktikës ligjore për të shtrirë më tej diskutimin.

## Burime

Studime të vendeve të Këshillit të Evropës mbi pengesat, mjetet juridike dhe praktikatat e mira për aksesin e grave në drejtësi për vendet e mëposhtme: Armeni, Azerbajxhan, Gjeorgji, Republika e Moldavisë dhe Ukrainë  
[https://www.coe.int/en/web/genderequality/equal-access-of-women-to-justice#{"14965347":0}](https://www.coe.int/en/web/genderequality/equal-access-of-women-to-justice#{)

## Sesioni 5: Aksesi në drejtësi në rastet e dhunës ndaj grave

Ky sesion inkurajon të mentoruarit që të shikojnë më nga afër pengesat me të cilat hasen gratë që janë viktime të dhunës me bazë gjinore (veçanërisht dhunës në familje) në sistemin ligjor. Në mënyrë ideale, ky sesion do të pasonte sesionin 4 në mënyrë që të mentoruarit të mund t'u referohen rezultateve të punës së tyre dhe diskutimeve nga ai sesion.

### Përkon me

Materiali bazohet në konceptet e prezantuara në Modulin 1 (seksioni 1.1.3) të *Manualit të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët mbi Sigurimin e Aksesit së Grave në Drejtësi* dhe të shtjelluara më hollësisht në Modulin 5 të kursit HELP mbi aksesin e grave në drejtësi.

### Objektivat e të nxënit

I mentoruari duhet të kuptojë më mirë se si pengesat ndaj drejtësisë kontribuojnë për zbehjen e rasteve të dhunës ndaj grave (veçanërisht, fenomeni i çështjeve që “dalin” nga sistemi ligjor ndërsa kalojnë nga ankimi penal në gjykim dhe dënim përfundimtar). Të mentoruarit duhet të mësojnë se si veprimet ose mosveprimet e profesionistëve të së drejtës përgjatë këtij “zinxhiri të drejtësisë” kanë ndikim mbi aksesin e grave në drejtësi. Të mentoruarit duhet të reflektojnë gjithashtu se si standardet e përcaktuara në Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) synojnë të rrisin aksesin e grave në drejtësi.


### Ndikimi i pritshëm

Të mentoruarit do të jenë në gjendje të identifikojnë pengesat ndaj drejtësisë për viktimat e dhunës ndaj grave dhe do të pranojnë se pengesa të tilla janë të ndërlydhura (p.sh. hetimi i papërshtatshëm i policisë ndikon mbi punën e prokurorëve; puna joadekuade e prokurorëve mund të çojë në shpallje pafajësie). Të mentoruarit duhet të kuptojnë rolin e tyre brenda zinxhirëve të drejtësisë dhe rëndësinë e qasjeve të koordinuara, sikurse parashikohet në Konventën e Stambollit.

### Përmbajtja/temat

- a. I mentoruari, si individ, ose në një grup të mentoruarish që punojnë së bashku, duhet të njihet me nocionin e “zinxhirit të drejtësisë” në një çështje penale të dhunës ndaj grave (shih faqen 18 të *Manualit të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët për Sigurimin e Aksesit të Grave në Drejtësi* ose punoni me Modulin 5 të kursit online). Një zinxhir tipik drejtësie në këtë rast fillon me kontaktin e parë që viktimat ka me sistemin e drejtësisë (zakonisht ndërveprimi me policinë) dhe përfundon me dënimin në një çështje penale dhe/ose proceset pas gjykimit. Zinxhiri i drejtësisë mund të përfaqësohet vizualisht si një seri hapash me pyetje dhe pajoja që i bashkëlidhen secilit hap. Skica mund të ketë këtë pamje:

## USHTRIM PRAKTIK I ZINXHIRIT TË DREJTËSISË



Në çdo fazë të zinxhirit të drejtësisë, përgjigjet e profesionistëve të ndryshëm të organeve të zbatimit të ligjit dhe profesionistëve të së drejtës do të kenë ndikim mbi rezultatin për viktimën, pra ose për të mos e çuar përpara çështjen, ose për ta shtyrë atë më tej përgjatë zinxhirit. Çdo hap mund të formulohet duke përdorur pyetje po/jo (p.sh. "A procedon prokurori me kallëzime penale- po/jo?") dhe më pas të shqyrtohet ndikimi i secilit vendimi.

- b. I mentoruari mund të imagjinojnë një skenar/çështje hipotetike të dhunës ndaj grave me të cilin është i njohur dhe të punojnë në çdo hap të zinxhirit të drejtësisë duke pyetur se cili do të ishte rezultati në varësi të mënyrës se si përgjigjet profesionisti ligjor përkatës (ose duke e çuar çështjen në një shkallë tjetër përgjatë zinxhirit të drejtësisë, ose duke çuar në pushimin e saj). I mentoruari duhet të supozojë se viktimia ka një pretendim legjitim sipas legjislacionit të brendshëm. Qëllimi nuk është të vlerësohet çështja përkatëse ligjore, por të kuptohet se si vendimet në faza të ndryshme mund të pengojnë një viktimë të ketë akses në drejtësi.

Përndryshe, i mentoruari mund të studiojnë faktet e çështjes *Volodina* kundër Rusisë (vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 9 korrikut 2019.<sup>6</sup>) dhe të gjejë korrespondencën midis veprimeve/mosveprimeve të profesionistëve përkatës të zbatimit të ligjit dhe profesionistëve të së drejtës përgjatë fazave të zinxhirit të drejtësisë duke parë pasojat për viktimën. Mbani parasysh se faktet e çështjes *Volodina* nuk do të zënë një zinxhir të tërë drejtësie, që do të thotë se zinxhiri do të përfundojë përpara se çështja të shkojë në gjyq..

- c. Pas përdorimit të zinxhirit të drejtësisë për të identifikuar uljet e numrit të çështjeve dhe për të diskutuar rezultate të ndryshme në një rast ilustrues të dhunës ndaj grave, i mentoruari mund t'i referohet Konventës së Stambollit, kryesisht Kreut VI mbi hetimin, ndjekjen penale, ligjin procedural dhe masat mbrojtëse dhe Kreut 2, nenit 7 mbi koordinimin. Duke studiuar detyrimet e përcaktuara në Konventën e Stambollit, i mentoruari mund të përputhë masat që nevojiten për të parandaluar uljen e rasteve (dhe për të përmirësuar aksesin e grave në drejtësi!) përgjatë pikave të ndryshme të zinxhirit të drejtësisë.

### Kujdes mentorë!

Kjo seancë përdor një vendim të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me Rusinë. Sigurohuni që të mentoruarit të mos e keqkuptojnë detyrën. Përdorimi i një çështjeje real nga një juridiksion tjetër nuk është për qëllim krahasimi apo për të kritikuar se si shtete të ndryshme reagojnë ndaj dhunës ndaj grave. Përkundrazi, çështjet për të cilat është marrë vendim nga Gjykata ngrënë tema që janë problematike për shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo çështje është zgjedhur pasi ka elementë tipikë për shumë shtete.

6. E disponueshme në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-194321>

## Ushtrime

- a. Të mentoruarit ose njihen me grafikun kampion të dhënë në manualin e trajnimit (ose më lart) të një zinxhiri drejtësie, rishikojnë ushtrimin e zinxhirit të drejtësisë në Modulin 5 të kursit HELP online, ose krijojnë një zinxhir drejtësie që përputhet me një formë të veçantë dhune kundër grave të cilën ata e njohin.
- b. Më pas, i mentoruari ose mund të shqyrtojë një rast hipotetik (një çështje “tipike” nga praktika e tyre), ose mund të punojë me një rast real në vendin e tyre. Në përgjithësi rekomandohet që të mentoruarit të mos përdorin një rast të cilin e njohin, pasi mund të ndodhë që ata të anashkalojnë veprimet/mosveprimet e pahijshme në sistemet e tyre ligjore ose të ngurrojnë të identifikojnë dështimet e grupeve të caktuara profesionale. Duke përdorur një çështje nga një juridiksion tjetër (këtu sugjerohet çështja Volodina nga Federata Ruse), të mentoruarit mund të diskutojnë mosveprimet e shtetit në një mënyrë më të hapur dhe “jopersonale”. Megjithatë, të mentoruarit duhet të inkurajohen të shkojnë më tej se çështja Volodina, që do të thotë të eksplorojnë rezultate të tjera hipotetike nëse çështja do të kishte shkuar në gjyq. Detyra e të mentoruarit është të punojë me secilën “hallkë” të zinxhirit të drejtësisë, duke identifikuar atë që ndodhi (ose çfarë shkoi keq) në çdo fazë dhe të diskutojë ndikimin e secilit rezultat në hallkën tjetër të zinxhirit dhe, në fund, të konstatojë nëse viktimja pati mundësi për të patur akses në drejtësi.
- c. Pasi të jetë shqyrtuar zinxhiri i drejtësisë dhe të shënohen pikat e dobësimit (p.sh. kur policia refuzoi të hapte një hetim penal, kjo do të thotë se viktimja ishte nënshtruar dhunës fizike dhe kërcënimeve të mëtejshme nga bashkëshorti i saj), i mentoruari duhet të rishikojë Konventën e Stambollit. Detyra tjetër është të shqyrtohet se cilat kërkesa konkrete të Konventës së Stambollit janë të rëndësishme në cilat pika të zinxhirit të drejtësisë. Do të ketë mbivendosje dhe përsëritje (p.sh. zbatim i ligjit duhet të kishte kryer një vlerësim të rrezikut, neni 51 i Konventës së Stambollit. Nëse do të ishte bërë kjo, një rezultat i mundshëm do të kishte qenë ...).

## Fusha për diskutim

- a. Cilat janë “lidhjet” e përgjithshme në një zinxhir drejtësie që përfshin një çështje penale të dhunës ndaj grave bazuar në praktikën tuaj (mbani parasysh se kjo mund të ndryshojë në varësi të formës së dhunës)? Mendoni, së pari, se si viktimat zakonisht vijnë në vëmendjen e sistemit të drejtësisë. Në çfarë faze përfundojnë shumica e rasteve të dhunës ndaj grave, me dënim? Shfajësimi? Apo diçka tjetër?  
  
A e njihni konceptin e dobësimit të rasteve të tilla? A ka parë i mentoruari ndonjë të dhënë për këtë fenomen?
- b. Gjatë rishikimit të çështjes Volodina (ose të një çështjeje tjetër që do të përzgjidhet nga mentori dhe i mentoruari), punoni në mënyrë sistematike përmes secilës “hallke” në zinxhir, duke imagjinuar se si ishte përvoja e zonjës Volodina në sistemin e drejtësisë. Për secilën fazë bëni pyetjen: *çfarë ndodhi?* (çfarë veprimi ndërmori znj. Volodina dhe çfarë veprimesh ndërmorën ose jo organet përkatëse ligjzbatuese/profesionistët e së drejtës?); *cila ishte pasoja në drejtim të shtyrjes më tej të çështjes apo pengimit të çështjes? Çfarë veprimesh të tjera mund të ishin ndërmarrë që do të ndryshonin rezultatin?*
- c. Bëni një listë të pikave kyçe të dobësimit të rastit të identifikuar prej jush, duke marrë parasysh si fazën e zinxhirit, ashtu edhe organet e zbatimit të ligjit/profesionistin përkatës të së drejtës të përfshirë. Mbani parasysh se koncepti i “zinxhirit të drejtësisë” tregon se si secila pjesë e sistemit është e lidhur me tjetrën, ndaj mos e përqendroni vëmendjen vetëm në një grup profesionistësh! Në vend të kësaj, merrni parasysh se si profesionistët të ndryshëm ndërveprojnë me njëri-tjetrin (p.sh. si e informojnë prokurorët policinë se cilat prova duhet të mblidhen në fazën e hetimit?)  
  
Tani, rishikoni Konventën e Stambollit, veçanërisht detyrimet në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale. Cilat masa të veçanta mund të parandalojnë dobësimin e rastit ose përshkallëzimin/përsëritjen e dhunës? Cilat masa do të përmirësonin aksesin në drejtësi për një viktimë të dhunës ndaj grave (p.sh. znj. Volodina) dhe si do të zbusnin ose hiqnin ato pengesat tipike ndaj drejtësisë?



## Savjeti za prilagođavanje

- ▶ Ky sesion është hartuar rreth një rasti “tipik” të dhunës në familje. Megjithatë, ushtrimi mund të zbatohet në mënyrë të barabartë për forma të tjera të dhunës ndaj grave, të tilla si përdhunimi, ngacmimi seksual, përndjekja, krimet e bazuara në nder, etj. Mentori mund të diskutojë me të mentoruarin fushat e së drejtës penale ku ai/ajo ka më shumë përvojë. Nëse ata janë të njohur me konceptin e zinxhirit të drejtësisë, mund të jetë një sfidë e dobishme për të mentoruarin të shqyrtojë se si një formë e dhunës ndaj grave, për të cilën nuk kanë punuar gjerësisht, mund të vazhdojë përmes zinxhirit të drejtësisë. Nga ana tjetër, nëse ideja e zinxhirit të drejtësisë është e re për ta, këshillohet që ata të përdorin një rast “tipik” të dhunës ndaj grave të njohur prej tyre.
- ▶ Ekzistojnë disa vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me dhunën ndaj grave dhe të gjitha mund të përdoren në një ushtrim që ka të bëjë me zinxhirin e drejtësisë. Përndryshe, mentori mund të krijojë një rast hipotetik për të nxjerrë në pah disa çështje për të mentoruarin (p.sh. në lidhje me veprimet konkrete të prokurorëve ose gjyqtarëve).

## Burime

Vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjen Volodina mund ta gjeni këtu: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-194321>

Teksti i Konventës së Stambollit është i disponueshëm në të gjitha gjuhët e Këshillit të Evropës këtu: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/text-of-the-convention>

Përveç kursit HELP mbi Aksesin e Grave në Drejtësi, të mentoruarit mund të dëshirojnë të regjistrohen në kursin HELP mbi Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje për të eksploruar temën në më shumë detaje. Ky kurs përfshin gjithashtu një modul mbi aksesin e grave në drejtësi. Është në dispozicion në disa gjuhë<sup>7</sup>.

Botimi *Progres of the World's Women: In Pursuit of Justice* përfshin një kre mbi konceptin e zinxhirit të drejtësisë (Kreu 2), me një rast studimor nga Bullgaria (*Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2008<sup>8</sup>) i informacije o odustajanju u slučajevima silovanja na osnovu studija sprovedenih u Južnoj Africi. (UN Women, 2011). E disponueshme në disa gjuhë: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2011/7/progress-of-the-world-s-women-in-pursuit-of-justice>

Botimi i *Librit burimor për trajnerë mbi përgjigjet efektive të ndjekjes penale ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave* përfshin një kre mbi pengesat që hasin gratë lidhur me akses në drejtësinë penale me një shembull të një ushtrimi të zinxhirit të drejtësisë (f. 102), i cili mund të jetë material i dobishëm referimi. (UNODC, 2017). [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Gender/16-09583\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Gender/16-09583_ebook.pdf)

7. <http://help.elearning.ext.coe.int>.

8. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016805a32ab>

## Sesioni 6: Zbatimi i të drejtës ndërkombëtare lidhur me të drejtat e grave në gjykatat kombëtare

Qëllimi i këtij sesioni është të forcojë aftësitë e profesionistëve për të zbatuar në mënyrë efektive standardet ligjore ndërkombëtare në procedurat e brendshme ligjore.

### Përkon me

Ky sesion rrjedh logjikisht nga materiali i paraqitur në Kreun 2 të *Manualit Trajnues për Gjyqtarët dhe Prokurorët mbi Sigurimin e Aksesit të Grave në Drejtësi* dhe Modulin 2 të kursit HELP, të cilat të dyja pasqyrojnë të drejtën ndërkombëtare përkatëse (të dyja legjislacione detyruese dhe legjislacione normative të OKB-së, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian).

### Objektivat e të nxënit

I mentoruari duhet të mësojë se si të zbatojë standardet ligjore ndërkombëtare në praktikën e tij/saj të rregullt për të mbrojtur të drejtat e grave. Ai/ajo duhet të kuptojnë se cilat traktate ose konventa (përfshirë legjislacionin dytësor) mund të zbatohen për raste konkrete dhe procedurën për futjen e tyre në çështjet ligjore.

### Ndikimi i pritshëm

Edhe nëse të mentoruarit janë të njohur me standardet ligjore ndërkombëtare lidhur me çështjet e të drejtave të grave, ata mund të mos dinë se si t'i zbatojnë këto standarde në praktikën e tyre të përditshme. I mentoruari do t'u referohet standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me gratë në mënyrë më të natyrshme, veçanërisht në fushat ku legjislacioni i brendshëm mund të mungojë.

### Përmbajtja/temat

Ky sesion mund të përdoret si studim vetjak i udhëzuar, ku i mentoruari eksploron procedurën për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare në juridiksionin e tij/saj.

### Ushtrimet

Ky ushtrim mund të kryhet duke përmbushur kronologjikisht detyrat e mëposhtme:

- Rishikoni burimet e së drejtës sipas sistemit të brendshëm ligjor dhe veçanërisht zbatueshmërinë e së drejtës ndërkombëtare (a trajtohet në të njëjtën mënyrë si ligji kombëtar në proceset e brendshme?).
- Identifikoni se ku ka mangësi në legjislacionin kombëtar që trajtohen nga e drejta ndërkombëtare (traktatet dhe legjislacioni dytësor) që kanë të bëjnë me të drejtat e grave ose çështjet gjinore.
- Rishikoni jurisprudencën dhe praktikën ligjore për të gjetur shembuj të gjykatave kombëtare që interpretojnë zbatimin ose duke u mbështetur në të drejtën ndërkombëtare.
- Identifikoni disa mënyra specifike se si i mentoruari mund të përpiqet të prezantojë standarde ndërkombëtare në praktikën e tij/saj.

### Fusha për diskutim

- A ka dallime në zbatueshmërinë e traktateve (legjislacioni i detyrueshëm) dhe legjislacionit dytësor? Cilat janë aspektet procedurale të përdorimit të burimeve të ndryshme të së drejtës?
- Pas rishikimit të instrumenteve bazë të të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me të drejtat e grave (p.sh. përmes kursit në internet HELP ose si lexim shtesë), cilat çështje keni identifikuar që trajtohen më hollësisht nga e drejta ndërkombëtare sesa në legjislacionin e brendshëm? Ose në cilat fusha

mendoni se e drejta ndërkombëtare specifike do të ofronte informacion të mëtejshëm se si të mbrohen më së miri të drejtat e grave?

- c. Si referohet zakonisht e drejta ndërkombëtare në çështjet e brendshme? Në cilat fusha të legjislativitetit?
- d. Ku mund të jetë e mundur t'i referohemi të drejtës ose standardeve ndërkombëtare, për shembull, në zhvillimin e argumenteve ligjore, paraqitjen e arsytimit ligjor ose në gjykime? A mund të mendoni për mundësi konkrete për të përdorur të drejtën ndërkombëtare në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e grave?

## Këshilla për përshtatje

- ▶ Nëse mentori përcakton se i mentoruari ka nevojë për udhëzime shtesë, ky sesion mund të prezantohet në një mënyrë tjetër. I mentoruari mund të zgjedhë një çështje nga praktika e tij/saj ose një çështje me të cilin ai/ajo është i/e njohur (një rast në lidhje me të drejtat e grave dhe në mënyrë ideale një rast kompleks). Ata mund të identifikojnë të gjithë ligjin kombëtar përkatës të cituar. Më pas ata mund të rishikojnë traktatet kryesore ndërkombëtare (Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut [KEDNJ], Konventën e Stambollit, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave [CEDAW], etj.) dhe të gjejnë se ku ka pika mbivendosjeje ose dallimi. Veçanërisht ku i forcojnë standardet ndërkombëtare argumentet juridike në çështjet që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të grave?
- ▶ Nëse nuk është e mundur të gjendet një çështje e vetme që është komplekse, mentori mund të përgatisë kazuse hipotetike që bazohen në fusha të ndryshme të së drejtës.

## Burime

Nëse të mentoruarit dëshirojnë të rishikojnë dokumentet thelbësore që kanë të bëjnë me të drejtat e grave, në këtë pjesë ata mund të gjejnë përmbledhje të sistemeve të Këshillit të Evropës dhe të OKB-së:

Standardet dhe mekanizmat e KiE-s mbi barazinë gjinore  
<https://www.coe.int/en/web/genderequality/standards-and-mechanisms>

Të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut, Zyra e OKB-së për Komisionerin e Lartë për të Drejtat e Njeriut (2014)  
<https://www.ohchr.org/Documents/Events/WHRD/WomenRightsAreHR.pdf>

Nëse të mentoruarit e kanë të vështirë të identifikojnë fushat ku ligji (ose praktika) kombëtare nuk i mbron në mënyrë të përshtatshme të drejtat e grave në vendin e tyre, ata mund të rishikojnë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Vendimet japin informacion mbi konstatimet e Gjykatës mbi legjislativitetin dhe/ose praktikën kombëtare që nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare (d.m.th. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut) që mund të zbatohen për shtetet e tjera anëtare. Këto vendime përmbledhen në fletët e fakteve të Gjykatës, të cilat përditësohen në mënyrë periodike.

Fletë faktike mbi barazinë gjinore:  
[https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Gender\\_Equality\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Gender_Equality_ENG.pdf)

Fletë faktike mbi dhunën në familje:  
[https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Domestic\\_violence\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Domestic_violence_ENG.pdf)

Fletë faktike mbi dhunën ndaj grave:  
[https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Violence\\_Woman\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Violence_Woman_ENG.pdf)

Divizioni për Barazi Gjinore ka përpiluar gjithashtu një botim mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjet e barazisë gjinore  
<https://rm.coe.int/compilation-echr-case-law-1-august-2019/168096d977>

Mund të konsultohen gjithashtu studime të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës mbi pengesat, mjetet juridike dhe praktikën e mira për aksesin e grave në drejtësi për vendet e mëposhtme: Armeni, Azerbajxhan, Gjeorgji, Republika e Moldavisë dhe Ukrainë:  
[https://www.coe.int/en/web/genderequality/equal-access-of-women-to-justice#{"14965347":0}](https://www.coe.int/en/web/genderequality/equal-access-of-women-to-justice#{)

## Sesioni 7: Puna me jurisprudencën

Qëllimi i këtij sesioni është të angazhojë të mentoruarin me çështje konkrete për të eksploruar se si rezultatet ligjore mund të ndryshojnë nëse çështje të caktuara do të ishin gjykuar nga gjykatat e vendit të tij/saj.

Seanca ka dy "pista"- (çështja A) e cila lidhet me një rast diskriminimi për shkak të seksit, për profesionistët e së drejtës civile dhe (çështja B) e cila lidhet me një rast të dhunës ndaj grave, për profesionistët e së drejtës penale. Mentori duhet të vendosë me të mentoruarin se me cilën lloj çështje do të punojnë dhe do të diskutojnë bashkërisht. Është gjithashtu e mundur të punohet me të dyja çështjet.

Për **çështjen e së drejtës civile**, qëllimi është që të lejohen të mentoruarit të eksplorojnë se si duhet të zgjidhet një rast diskriminimi për shkaqe gjinore, duke parë standardet, çështjet e provave dhe provat e nevojshme për tjetërsimin e barrës së provës.

Për **çështjen e së drejtës penale**, qëllimi është që të mentoruarit të eksplorojnë se si një çështje nga një vend që nuk ka ratifikuar Konventën e Stambollit mund të ishte vendosur ndryshe nga gjykata (ose cilat argumente ligjore do të ishin parashtruar ndryshe) nëse vendi do të ishte palë në Konventë.

### Përkon me

Ky sesion bazohet në konceptet ligjore të paraqitura në seksione të ndryshme të *Manualit të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët mbi Sigurimin e Aksesit të Grave në Drejtësi* dhe të kursit HELP. Për çështjen që ka të bëjë me diskriminimin (çështja A), materiali referues mund të gjendet në Modulin 1 (seksioni 1.3) dhe Modulin 4 (seksioni 4.3 për çështjet e provave). Moduli 3 i kursit HELP ka të bëjë me diskriminimin për shkak të seksit dhe gjinisë.

Për një çështje që ka të bëjë me dhunën ndaj grave (çështja B), materiali referues gjendet në Modulet III dhe 1V të *Manualit të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët për Sigurimin e Aksesit të Grave në Drejtësi*, si dhe në Modulet 2 dhe 5 të kursit HELP.

### Objektivat e të nxënimit

I mentoruari duhet të fitojë praktikë lidhur me zbatimin e standardeve ndërkombëtare që mund të mos përdoren gjerësisht në vendin e tij. Duke reflektuar mbi praktikën ndërkombëtare, të mentoruarit duhet të mësojnë kur e drejta ndërkombëtare ofron mbrojtje për shkeljet e të drejtave dhe standardet që nuk mbulohen gjithmonë në legjislacionin e brendshëm.

### Ndikimi i pritshëm

I mentoruari do të jetë në gjendje të kuptojë rëndësinë e së drejtës dhe standardeve ndërkombëtare. Ai/ajo gjithashtu do të jetë në gjendje të praktikojnë se si mund të parashtrihen argumentet ligjore bazuar në të drejtën kombëtare si dhe në të drejtën ndërkombëtare.

### Përmbajtja/temat

Sugjerohet që modelet e fakteve të studiuara nga të mentoruarit të bazohen në komunikime reale të shqyrtuara nga Komiteti CEDAW. Rishikimet e bëra nga Komitetit nuk janë procese gjyqësore, por përfshijnë referencë ndaj legjislacionit dhe procedurës kombëtare. I mentoruari duhet të shqyrtojë çështjet dhe gjetjet e Komitetit CEDAW. Më pas, i mentoruari duhet të diskutojë se si do të gjykohet dhe vendoset për të njëjtën çështje në juridiksionin e tij/saj. I mentoruari duhet të zhvillojë argumentet e veta ligjore, duke iu referuar legjislacionit të brendshëm si dhe legjislacionit ndërkombëtar përkatës. Sugjerohet që të mentoruarve t'u jepen fillimisht faktet (nga komunikimet për Komitetin CEDAW) dhe më pas të lexohen përfundimet e Komitetit pasi të kenë dhënë argumentet e tyre ligjore.

### Kujdes mentorë!

Ky sesion përdor vendimet e Komitetit CEDAW në lidhje me Sllovakinë dhe Rusinë. Sigurohuni që të mentoruarit të mos e keqkuptojnë detyrën. Përdorimi i çështjeve reale nga juridiksione të tjera nuk është për qëllim krahasimi apo për kritikë mbi mënyrën sesi shtete të ndryshme reagojnë ndaj dhunës ndaj grave. Përkundrazi, këto raste përfshijnë çështje ligjore që janë problematike për shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës.

## Çështja A: Diskriminim për shkak të seksit

Bazuar në faktet e komunikimit të D.S. (Sllovaki) drejtuar Komitetit të CEDAW.

Çështja ka të bëjë me shkarkimin e D.S-së nga puna pas marrjes së lejes së lindjes. D.S.-ja pretendonte se ishte subjekt i diskriminimit për shkaqe gjinore nga punëdhënësi i saj.

I mentoruari duhet të lexojë faktet dhe rrethanat e çështjes dhe të zhvillojë një teori të çështjes, të përcaktojë ligjin e zbatueshëm (sikur çështja të ishte duke u shqyrtuar në vendin e të mentoruarit), të identifikojë format e mundshme të provave, të diskutojë provat që janë të mjaftueshme për të vërtetuar një çështje prima facie dhe për të tjetërsuar barrën e provës dhe të japë një vendim sikur çështja të gjykohej në sistemin ligjor të vendit të të mentoruarit. Vetëm pasi ta ketë bërë këtë, i mentoruari duhet të rishikojë përfundimet e Komitetit të CEDAW. Në këtë rast, Komiteti konstatoi se kishte diskriminim në kundërshtim me CEDAW.

## Çështja B: Dhuna ndaj grave

Bazuar në faktet e komunikuar nga X dhe Y. (Federata Ruse) pranë Komitetit CEDAW.

Çështja ka të bëjë me personat X dhe Y të cilët të dy iu nënshtruan dhunës në familje dhe pretenduan se shteti nuk arriti të përmbushë detyrimin e tij për ofrimin e kujdesit të duhur, përkatësisht hetimin dhe ndjekjen penale të autorëve të dhunës.

I mentoruari duhet të lexojë faktet dhe rrethanat e çështjes dhe të zhvillojë një teori të çështjes, të përcaktojë ligjin e zbatueshëm (sikur çështja të ishte duke u shqyrtuar në vendin e të mentoruarit), të identifikojë format e mundshme të provave dhe të fushave për hetim/ndjekje penale dhe të japë një vendim sikur çështja të gjykohej në sistemin ligjor të vendit të të mentoruarit. Vetëm pasi ta ketë bërë këtë, i mentoruari duhet të rishikojë përfundimet e Komitetit të CEDAW. Në këtë rast, Komiteti konstatoi se kishte diskriminim në kundërshtim me CEDAW, duke marrë gjithashtu parasysh edhe shumë rekomandime të përgjithshme të Konventës.

Mbani parasysh se deri në momentin e këtij komunikimi, Rusia nuk e kishte ratifikuar Konventën e Stambollit. Një nga detyrat e të mentoruarit duhet të jetë kërkimi i shkeljeve të mundshme të Konventës së Stambollit.

## Ushtrime

### Udhëzime për të mentoruarit lidhur me Çështjen A

Ky ushtrim mund të kryhet duke përmbushur kronologjikisht detyrat e mëposhtme:

- Shqyrtoni vetëm faktet e çështjes në lidhje me diskriminimin për shkak të gjinisë (këtu, në lidhje me punësimin).
- Shqyrtoni faktet e çështjes në kontekstin e juridiksionit tuaj. Paraqisni argumentet ligjore lidhur me një çështje diskriminimi për shkaqe gjinore duke u mbështetur në legjislacionin e brendshëm përkatës si dhe në standardet ndërkombëtare (që i mentoruari mendon se janë të zbatueshme).
- Identifikoni format e mundshme të provave. Këto mund të shkojnë përtej atyre që përmenden në faktet e çështjes. I mentoruari duhet të identifikojë se cilat forma të mundshme të provave janë të mjaftueshme për të vërtetuar një çështje prima facie dhe për të tjetërsuar barrën e provës te i padituri/punëdhënësi për të vërtetuar se vendimi për ndërprerjen e punësimit nuk ishte diskriminues.
- I mentoruari dhe mentori mund të diskutojnë argumentet dhe provat ligjore. Në fund, i mentoruari duhet të luajë rolin e gjyqtarit dhe të japë një vendim të mundshëm.
- Hapi i fundit është rishikimi i vendimit dhe rekomandimeve të Komitetit CEDAW, duke pasur parasysh se ky nuk është vendim detyrues gjykatë. Në këtë pikë, mentori dhe i mentoruari mund të diskutojnë dallimet nëse ky rast: (a) do të ishte gjykuar nga një gjykatë në vendin e të mentoruarit; ose (b) nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me synimin për të identifikuar mangësitë e mundshme në ligji në mjedisin e brendshëm juridik që trajtohen nga e drejta ndërkombëtare.

### Udhëzime për të mentoruarit lidhur me Çështjen B

Ky ushtrim mund të kryhet duke përmbushur kronologjikisht detyrat e mëposhtme:

- a. Shqyrtoni vetëm faktet e çështjes në lidhje me dhunën ndaj grave (këtu, në lidhje me dhunën në familje).
- b. Shqyrtoni faktet e çështjes në kontekstin e juridiksionit tuaj. Përcaktoni se cilat ligje zbatohen për këtë çështje (e drejta penale dhe e drejta e procedurës penale, si dhe mbase dhe e drejta civile ose administrative).
- c. Cilat standarde ndërkombëtare janë të zbatueshme për faktet e kësaj çështjeje? Mbani parasysh se Federata Ruse nuk ishte palë në Konventën e Stambollit në kohën kur u shqyrtua çështja. Megjithatë, i mentoruari duhet ta shqyrtojë këtë çështje sikur shteti të ishte i detyruar të respektonte dispozitat e Konventës. Gjithashtu merrni parasysh çdo standard tjetër ndërkombëtar të zbatueshëm.
- d. Identifikoni provat e mosveprimit të shtetit të këtë çështje. Identifikoni edhe veprime të tjera që duhet të kishin ndërmarrë policia apo prokuroria, nëse kjo çështje do të kishte ndodhur në vendin tuaj.
- e. I mentoruari dhe mentori mund të diskutojnë argumentet dhe provat ligjore. Në fund, i mentoruari duhet të luajë rolin e gjyqtarit dhe të japë një vendim të mundshëm.
- f. Hapi i fundit është rishikimi i vendimit dhe rekomandimeve të Komitetit CEDAW, duke pasur parasysh se ky nuk është vendim detyrues gjykatë. Në këtë pikë, mentori dhe i mentoruari mund të diskutojnë dallimet nëse ky rast: (a) do të ishte gjykuar nga një gjykatë në vendin e të mentoruarit; ose (b) nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut lidhur me të njëjtat fakte në një shtet që ka ratifikuar Konventën e Stambollit.

## Oblasti za diskusiju

### Fusha për diskutim

- a. Pas leximit të fakteve të paraqitura nga autori (D.S.), a ka ndonjë dallim në mënyrën se si ligji kombëtar në këtë çështje (në Sllovakia në këtë rast) dhe në vendin tuaj e trajton diskriminimin për shkak të gjinisë (ose për shkak të seksit)? Cilat janë këto dallime?
- b. Duke e vënë veten në rolin e avokatit të D.S., cili ligj zbatohet për rastet e diskriminimit në vendin tuaj?
- c. Cilat standarde ligjore ndërkombëtare mund të përdoren në këtë rast? Mendoni për CEDAW si dhe për konventat e Këshillit të Evropës.
- d. Pas leximit të konstatimeve të shtetit palë (“mbrojtja”) dhe komenteve të ankuesit, cilat janë format e mundshme të provave që mund të paraqesë ankuesi dhe ato që mund të paraqesë shteti (“pala e paditur”) (mund të hartoni një listë)? Inkurajoheni të jeni krijues dhe të mendoni përtej fakteve të çështjes dhe të merrni parasysh provat që mund të jenë të disponueshme në vendin tuaj. Cilat prova do të ishin të mjaftueshme që D.S.-ja të kishte një çështje prima facie sipas legjislacionit të brendshëm? Mendoni për praktikën gjyqësore që njihni. Nëse kjo pyetje është e vështirë për t’u përgjigjur, mbajeni parasysh atë kur të rishikoni më vonë konstatimin e Komitetit CEDAW lidhur me tjetërsimin e barrës së provës.
- e. Tani, duke e vënë veten në rolin e gjyqtarit, çfarë do të vendosni, ose si do ta arsyetonit një vendim në favor të D.S.-së (që do të thotë, një konstatim që punëdhënësi i saj e ka diskriminuar atë)?
- f. Analizoni përfundimet e Komitetit CEDAW. Mbani parasysh se Komiteti konstatoi shkelje të Konventës. A mendoni se gjykimi do të ishte i njëjtë nëse kjo çështje do të shqyrtohej nga sistemi ligjor i vendit tuaj ose duke u mbështetur vetëm në legjislacionin e brendshëm ose duke iu drejtuar gjithashtu edhe të drejtës ndërkombëtare (siç është CEDAW)? A prisni të shihnit ndonjë dallim nëse kjo çështje do të ishte shqyrtuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut duke u mbështetur në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut?

### Lidhur me Çështjen B

- a. Pas leximit të fakteve të paraqitura nga autorët (X dhe Y), a ka ndonjë dallim në mënyrën se si ligji kombëtar në këtë çështje (në Federatën Ruse në këtë rast) dhe në vendin tuaj e trajton dhunën në familje? Cilat janë këto dallime?
- b. Duke e vënë veten në rolin e avokatit të X dhe Y, cili ligj zbatohet për rastet e dhunës në familje në vendin tuaj (e drejta penale dhe e drejta e procedurës penale, si dhe mbase dhe e drejta civile ose administrative)? A ekzistojnë mjete efektive ligjore në vendin tuaj të cilat nuk janë të disponueshme për personat X dhe Y?

- c. Cilat detyra ligjore të policisë ose prokurorëve do të implikoheshin nëse kjo çështje do të kishte ndodhur në vendin tuaj?
- d. Imagjinoni sikur faktet e kësaj çështjeje të kishin ndodhur në një shtet palë në Konventën e Stambollit, çfarë nenesh do të përdornit për të vërtetuar mosveprimin e shtetit në këtë çështje?
- e. Çfarë përbën provë të mundshme të mospërbushjes së detyrimit të shtetit për ofrimin e kujdesit të nevojshëm në këtë çështje?
- f. Analizoni konstatimet e shtetit (“mbrojtja”); si do t’i përgjigjeshit ju, si avokat i personit X dhe Y, këtyre argumenteve?
- g. Tani, duke e vënë veten në rolin e gjyqtarit, çfarë do të vendosni, apo ku do të konstatonit shkelje të legjisllacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar?
- h. Analizoni përfundimet e Komitetit CEDAW. Mbani parasysh se Komiteti ka konstatuar shkelje të CEDAW. A mendoni se gjykimi do të ishte i njëjtë nëse kjo çështje do të shqyrtohej në sistemin juridik të vendit tuaj? Çfarë do të ndodhte nëse çështja të shqyrtohej nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke u mbështetur në Konventën e Stambollit?

## Burime

Çështje të lidhura me diskriminimin:

Komunikimet e D.S.-së (pikëpamjet e Komitetit CEDAW lidhur me Komunikatën nr. 66/2014)  
<https://digitallibrary.un.org/record/854547>

Komunikimet e R.K.B. (pikëpamjet e Komitetit CEDAW lidhur me Komunikatën nr. 28/2010)  
<https://juris.ohchr.org/Search/Details/1720>

Çështjet e dhunës ndaj grave:

Komunikimi i personit X dhe Y (pikëpamjet e Komitetit CEDAW lidhur me Komunikatën nr. 100/2016)  
<https://undocs.org/pdf?symbol=en/CEDAW/C/73/D/100/2016>

Komunikimi i O.G.-së (pikëpamjet e Komitetit CEDAW lidhur me Komunikatën nr. 91/2015)  
<https://juris.ohchr.org/Search/Details/2429>



## Sesioni 8: Çfarë mund të bëhet për të eliminuar stereotipet gjinore në proceset gjyqësore?

Ky sesion përqendrohet në një pengesë kritike të aksesit të grave në drejtësi, mbështetjen të stereotipeve gjinore në rastet e dhunës ndaj grave. Qëllimi është që t'i kërkohej të mentoruarit të shqyrtojë disa shembuj të jashtëzakonshëm të njëanshmërisë gjinore në vendimmarrjen e gjykatave dhe të reflektojë si për dëmin e shkaktuar ashtu edhe për mënyrën sesi sistemi ligjor i përgjigj secilit rasti.

### Përkon me

Rekomandohet që ky sesion të zhvillohet pasi i mentoruari të jetë prezantuar me temat e stereotipeve dhe paragjyqimeve gjinore në proceset gjyqësore. Ky material mund të gjendet në seksionin 1.4 të *Manualit të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurorët mbi Sigurimin e Aksesit të Grave në Drejtësi* dhe në Modulin 4 të kursit HELP. Këshillohet që për qëllim të këtij sesioni të shikohen më thellë stereotipet gjinore dhe të reflektohet mbi pasojat negative të tyre mbi çështjet ligjore, me udhëzimin e mentorit.

### Objektivat e të nxënit

I mentoruari do të njihet me paragjykimet e zakonshme/vendimmarrjen stereotipike (të tilla si fajësimi i viktimeve në rastet e dhunës ndaj grave; moskuptimi i dinamikës së dhunës/përdhunimit seksual; keqinformimi mbi pëlqimin në çështje të tilla, etj.) dhe do të fillojë të deshifrojë nga vijën këto nocione stereotipike si dhe dëmin që shkaktojnë ato. I mentoruari duhet gjithashtu të krijojë përgjigje të mundshme ndaj paragjyqimeve të tilla gjinore dhe të shpjegojë se si ai/ajo, si profesionist i së drejtës, mund t'i bllokojë stereotipet ose t'i parandalojnë ato që të shkaktojnë dëm.

### Ndikimi i pritshëm

I mentoruari do të kuptojë se stereotipet dhe keqkuptimet mbi dhunën seksuale (si dhe format e tjera të dhunës ndaj grave), janë për fat të keq, reagime të zakonshme që ndodhin në të gjithë shoqërinë. Kur këto stereotipizime ndikojnë në vendimmarrjen ligjore, krijohen pengesat më kritike për aksesin e viktimeve të dhunës me bazë gjinore në drejtësi (dhe gjithashtu një arsye për krimet të tilla konsiderohen të fjetura). I mentoruari do të kuptojë se është përgjegjësi e profesionistëve të së drejtës të sigurojnë që paragjykimet dhe mbështetja të stereotipet për të interpretuar provat dhe për të zbatuar ligjin nuk janë pjesë e vendimmarrjes ligjore. Ata duhet të ndihen të fuqizuar për të identifikuar paragjyqime dhe stereotipizime të tilla dhe për të parandaluar që ato të ndodhin në vendimmarrjen e tyre dhe në proceset ligjore në përgjithësi.

### Përmbajtja/temat

Të mentoruarit i jepet informacion (ose i kërkohej të bëjë disa kërkime) në lidhje me rastet e fundit dhe veçanërisht ato skandaloze të stereotipizimit/paragjykimit gjinor. Jepen tre shembuj dhe mentorit mund t'i kërkojë të mentoruarit të marrë parasysh një, ose të tre shembujt, ose mund të zgjedhë raste të tjera problematike. Mentorit e udhëzon të mentoruarin të reflektojë mbi atë që fshihet pas vendimeve gjyqësore, cilat janë stereotipet e veçanta që po përforcohen, dëmi i shkaktuar dhe gjithashtu reagimet publike pasuese.

#### Kujdes mentorë!

Përmbledhjet e dhëna më poshtë nuk janë histori të plota të çështjeve. Qëllimi i ushtrimit nuk është rishikimi i vendimmarrjes gjyqësore për një çështje të tërë, por përqendrimi në shembuj se si stereotipet gjinore mund të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme në proceset ligjore.

Ka shembuj të qartë të stereotipizimit gjinor në secilën çështje. I mentoruari nuk duhet të inkurajohet të gjejë justifikime për këtë praktikë.

Mbani parasysh se disa të mentoruar mund të kenë të njëjtat keqkuptime, pasi, në fund të fundit, këto besime janë të zakonshme në shumicën e shoqërive. Për rrjedhojë, të mentoruarit mund të përipiqen t'i pakësojnë ato ose të japin shpjegime për të justifikuar keqkuptimet e tyre. Është e rëndësishme që mentorit të përcjellë një pikë kyçe të të nxënit: këto janë shembuj të profesionistëve të së drejtës që mbështeten në mënyrë të gabuar në stereotipet gjinore dhe kjo nuk mund të justifikohet.



## Ushtrime

Tri shembujt e propozuar jepen më poshtë. Informacioni i mëtejshëm lidhur me këto çështje mund të gjendet në media, në adresat e dhëna në referenca.

**Spanjë:** (çështja “tufa e ujqërve”)<sup>9</sup> Në vitin 2018, pesë burra u akuzuan për përdhunimin në grup të një vajze 18-vjeçare. Ata u shpallën fajtorë për veprën (më të lehtë) “abuzim seksual i vazhdueshëm”, por jo për përdhunim. Çështja kishte disa aspekte problematike. Për shembull, vepra penale e përdhunimit sipas ligjit spanjoll duhet të përfshijë dhunë ose frikësim. Avokati mbrojtës argumentoi se viktima kishte dhënë pëlqimin për aktin, duke përdorur pamjet në video në telefon që tregonin viktimën që qëndronte pa lëvizur me sy mbyllur si dëshmi se nuk kishte pasur dhunë/kanosje. Mbrojtja gjithashtu dorëzoi prova, të marra nga një detektiv privat, të viktimës duke buzëqeshur me miqtë e saj disa ditë pas ngjarjes. Gjyqtari konstatoi se “pasiviteti” i viktimës nënkuptonte se nuk kishte përdhunim. Pas vendimit, pati protesta të gjera publike në Spanjë dhe thirrje për të ndryshuar legjislacionin për veprat seksuale. Në vitin 2019, Gjykata e Lartë e rrëzoi vendimin dhe e zgjati dënimet nga 9 në 15 vjet. Aktualisht po rishikohet ligji për krimet e përdhunimit dhe sulmit seksual dhe ai mund të ndryshohet..

**Italia<sup>10</sup>:** Në vitin 2016, një gjykatë e shkallës së parë dënoi dy burra për përdhunimin e një gruaje 22-vjeçare (e cila ishte me origjinë nga Peruja). Në vitin 2017, burrat u shpallën të pafajshëm nga Gjykata e Apelit. Arsyetimi i Gjykatës së Apelit (me trup gjykues prej 3 gjyqtarësh femra) përfshinte faktin se dëshmia e viktimës nuk ishte e besueshme për shkak se ajo ishte e shëmtuar/“dukej shumë si burrë” për të qenë e dëshirueshme (bazuar në faktin se gjyqtarët kishin parë foton e saj dhe të pandehurit kishin deklaruar se ajo nuk ishte tërheqëse). Për këtë çështje kishte prova mjeko-ligjore se viktima kishte lëndime që përkonin me përdhunimin dhe se ishte droguar. Në vitin 2019, Gjykata e Lartë urdhëroi rihapjen e çështjes. Ministria e Drejtësisë urdhëroi një hetim të vendimit.

**Irlanda e Veriut<sup>11</sup>:** Në një gjykim të vitit 2018, ku një vajzë 17-vjeçare akuzoi një burrë 27-vjeçar për përdhunim, çështje vendimtare ishte nëse viktima kishte dhënë pëlqim për ndonjë akt seksual. Në fjalën e saj përmblylëse para trupit gjykues, avokatja mbrojtëse bëri deklaratën e mëposhtme: “A e përjashtojnë provat mundësinë që ajo të ishte tërhequr nga i pandehuri dhe të ishte e hapur për të takuar dikë dhe për të qenë me dikë? Duhet të shihni mënyrën se si ishte veshur. Ajo kishte veshur një tanga [të brendshme] me një dekolte prej dantelle”. Pas diskutimit, trupi gjykues e shpalli të pafajshëm të pandehurin. Kjo u pasua me protesta të shumta dhe deklarata që dënonin vendimin në Parlament. Më pas, Bordi i Drejtësisë Penale vendosi të bëhej një rishikim i pavarur i ligjit dhe procedurave në lidhje me shkeljet seksuale në Irlandën e Veriut.

## Fusha për zbatim

- ▶ Çfarë është problematike në secilin prej çështjeve? Cilat janë stereotipet konkrete gjinore, apo keqkuptimet për dhunën seksuale, që po përforcohen? Pse është problematike kjo praktikë?
- ▶ Mbani parasysh se si stereotipet dhe mitet rreth përdhunimit dhe dhunës seksuale përforcohen në secilën prej këtyre çështjeve. Si bëhej ky përforcim, përmes argumenteve ligjore, vendimit të gjykatës apo edhe vetë nga ligjet? Çfarë dallimesh ka për sa i përket ndikimit kur stereotipi gjinor ka “burime” të ndryshme?
- ▶ A sugjeron vendimmarrja ligjore apo argumentet ligjore në secilën prej këtyre çështjeve se kuptohet dinamika e çështjeve të përdhunimit? Çfarë nuk kuptohet?
- ▶ Çfarë mund të ishte bërë ndryshe? Vendoseni veten në rolin e prokurorit ose gjyqtarit (ose një profesionist tjetër të së drejtës) dhe merrni parasysh veprimet e mundshme, për sa i përket kundërshtimeve, udhëzimeve të jurisë, shqyrtimit tuaj, ndryshimeve ligjore etj.
- ▶ Nëse ndonjë nga këto çështje do të kishte ndodhur në vendin tuaj, çfarë mund të bëhet për të “dërguar një sinjal” se paragjykimi gjinor dhe mbështetja te stereotipet gjinore janë të papranueshme? (p.sh. a ka procedura disiplinore? A ka hetime të pavarura apo procese të reformës ligjore?)

9. <https://www.theguardian.com/world/2018/apr/26/protests-spain-five-men-cleared-of-teenagers-gang-rape-pamplona>;

10. <https://www.theguardian.com/world/2019/mar/11/men-acquitted-of-charges-because-victim-judged-too-masculine>

11. <https://www.irishexaminer.com/breakingnews/ireland/comment-investment-needed-to-change-attitudes-towards-consent-and-rape-885955.html>

- ▶ Tre shembujt kanë qenë objekt i protestave kombëtare dhe janë pasqyruar në shtypin ndërkombëtar. Pse mendoni se ka ndodhur kjo? Mendoni se këto çështje janë atipike apo përmbajnë disa elementë të njohur?
- ▶ Cili ishte rezultati përfundimtar i këtyre tre çështjeve sa i takon funksionimit më të mirë të sistemit të drejtësisë për viktimat e përdhunimit apo formave të tjera të dhunës seksuale? Cilat janë mësimet e nxjerra?
- ▶ A mund të mendoni për mënyra se si sistemi ligjor (dhe profesionistët e së drejtës) mund të jetë më proaktiv për trajtimet mbi stereotipet dhe paragjykimet gjinore, në vend që të reagojë ndaj rasteve si këto që shkaktojnë dëm të konsiderueshëm (për viktimën, por edhe minojnë besimin tek institucionet në përgjithësi)?

## Këshilla për përshtatje

- ▶ Pritet që ky sesion të përdoret pasi i mentoruari të ketë studiuar më parë stereotipet gjinore (qoftë përmes manualit të trajnimit ose përmes kursit online). Megjithatë, nëse mentori vëren se i mentoruari ka vështirësi për identifikimin e stereotipeve problematike gjinore në kazuset e disponueshme, mentori duhet të kërkojë që i mentoruari të lexojë disa materiale nga seksioni Burimet, i cili jepet më poshtë. Kjo mund të jetë gjithashtu një mënyrë për të filluar seancën dhe për të rifreskuar kujtesën e të mentoruarit.
- ▶ Një qasje më e avancuar mund të jetë që t'i kërkohet të mentoruarit të rishikojë shembuj nga përvoja dhe praktika e tij/saj. Kjo kërkon vetëreflektim mbi paragjykimet dhe anësitë personale. Qëllimi nuk është të fajësojmë të mentoruarin, por të kuptojmë se mitet mbi dhunën seksuale janë të zakonshme (vini re vendet/sistemet e ndryshme ligjore në shembujt që jepen në ushtrim) dhe se mendimi ynë ka ndryshuar me kalimin e kohës (mendoni se si trajtoheshin me ligj rastet e dhunës kundër grave 20 vjet më parë ose 100 vjet më parë).
- ▶ Të mentoruarit gjithashtu mund të identifikojnë dhe të diskutojnë llojet e stereotipeve gjinore që mund të hasen në çështje të tjera përveç dhunës seksuale. Një shembull do të ishte diskutimi se si rastet e përdhunimit bashkëshortor trajtohen në legjislacionin kombëtar. A ka mbrojtje ndaj përdhunimit kur dhunuesi dhe viktimja janë të martuar? A ka pasur ndryshime të ligjit dhe ndryshim të trajtimit ligjor të çështjeve të tilla? Cilat janë këto ndryshime dhe pse janë të rëndësishme ato?

## Burime

Për informacione të mëtejshme rreth stereotipeve gjinore dhe paragjykimeve gjinore, materialet e mëposhtme mund të jenë të dobishme për të mentoruarit:

Eliminimi i stereotipeve gjyqësore: Aksesi i barabartë në drejtësi për gratë në rastet e dhunës për shkak të gjinisë (Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, 2014)

Stereotipizimi gjinor si shkelje e të drejtave të njeriut (Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, 2013) <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Women/WRGS/Pages/GenderStereotypes.aspx>

## Sesioni 9: Përdorimi i praktikave të ndjeshme gjinore në jetën reale

Qëllimi i këtij sesioni është të inkurajojë të mentoruarin që të vendosë veten në vendin e një përdorueseje femër të drejtësisë, për shembull, një viktime të dhunës për shkaqe gjinore, në mënyrë që të identifikohen pengesat që mund të korrigjohen ndaj drejtësisë.

### Përkon me

Ky sesion mund të përdoret në çdo kohë në Programin e Mentorimit. Ai korrespondon me materialin e paraqitur në Kreun 4 të manualit të trajnimit dhe Modulet 5 dhe 6 të kursit HELP mbi aksesin e grave në drejtësi.

### Objektivat e të nxënit

I mentoruari duhet të shohë praktikën e veta dhe hapësirat e punës përmes syve të grave që përpiqen të kenë akses në drejtësi. Ai/ajo duhet të analizojnë në mënyrë kritike mjedisin e punës dhe të identifikojnë pengesat e mundshme për aksesin në drejtësinë dhe sistemet ose praktikën që mund të përmirësohen. Objektivi nuk është që i mentoruari të gjejë gabime të bashkëpunëtorëve ose personeli tjetër, por të shohë në mënyrë gjithpërfshirëse llojet e problemeve me të cilat mund të përballet një grua që përpiqet të ketë akses në drejtësi.

### Ndikimi i pritshëm

I mentoruari do të zbatojë çfarë ka mësuar nga kursi i trajnimit dhe programi për të identifikuar fushat konkrete ku mund të bëhen përmirësime në mjedisin e punës. Të mentoruarit që janë nga e njëjta praktikë/zyre mund ta bëjnë këtë ushtrim së bashku, dhe i mentoruari mund të angazhojë gjithashtu profesionistë të tjerë në këtë "rishikim".

### Përmbajtja/temat

Sesioni mund të marrë trajtën e një "mini auditimi gjinor" ku i mentoruar shqyrton në mënyrë kritike mjedisin e punës (jo vetëm hapësirën fizike, por edhe politikën, procedurat, etj.) nga këndvështrimi i një gruaje hipotetike përdoruese të drejtësisë. Hapi tjetër do të ishte që i mentoruari të raportojë për gjetjet (ose individualisht me mentorin ose në një mjedis grupi) dhe të zhvillojë rekomandime për përmirësime.

Auditimet gjinore zakonisht përdoren për të përmirësuar integrimin gjinor në një organizatë dhe mund të jenë një proces i gjerë. Auditimet gjinore mund të përdoren gjithashtu për të vlerësuar legjislacionin kombëtar nga perspektiva gjinore. Këtu, procesi është shumë më i kufizuar dhe synohet të kryhet nga një i mentoruar për disa ditë.

### Ushtrime

Mentori i kërkon të mentoruarit ta shohë vendit e punës me një sy kritik dhe të dallojë llojet e çështjeve për të cilat ai ka mësuar. Ushtrimi mund të përshkruhet si një "mini auditim gjinor" që është shumë më pak i gjerë se sa një auditim i plotë, ose mund të jetë një ushtrim i përgjithshëm ku i mentoruari e vendos veten në rolin e një gruaje që po përpiqet të ketë akses në drejtësi (shih Burimet, më poshtë).

Mentori dhe i mentoruari ose të mentoruarit mund të hartojnë së bashku një listë kontrolli për këtë auditim gjinor, duke përdorur sugjerimet e mëposhtme dhe duke përshtatur listën e punës së të mentoruarit (d.m.th. nëse ata janë prokurorë, gjyqtarë civilë apo penalë). Mentori duhet të inkurajojë të mentoruarin që jo vetëm të shikojë hapësirën fizike, por edhe, për aq sa është e mundur, njohuritë dhe veprimet e njerëzve në zyrë (p.sh. asistentët e prokurorëve, nëpunësit në gjykatë, përmbauesit, etj.), proceset, politikën, etj. Të mentoruarit duhet gjithashtu të lëvizin nëpër mjedisin e punës (jo vetëm të mendojnë për të), të flasnin me personelin, të shohin hapësirën fizike dhe të shohin çështjet procedurale për të provuar dhe identifikuar problemet/pengesat e mundshme për gratë. Nëse ka një grup të përzier të mentoruarish, ata mund të vizitojnë edhe zyrat e njëri-tjetrit.

### Lista e kontrollit:

Rishikimi i politikave, procedurave dhe proceseve nga perspektiva e ndjeshmërisë/neutralitetit/verbërisë gjinore (d.m.th. a ka instruksione ose udhëzime të brendshme për intervistimin e një viktime të dhunës me bazë gjinore?)

Njohuritë dhe ndjeshmëria e personelit ndaj çështjeve gjinore (d.m.th. a i kupton personeli siç duhet nevojat e grave si përdoruese të drejtësisë? A ka ndonjë trajnim për personelin?) Shënim: të mentoruarit mund të intervistojnë anëtarë të përzgjedhur të personelit ose të mbajnë një takim në grup të fokusuar.

Bëni një shëtitje në hapësirën fizike (d.m.th. a disponohet informacion që trajton në mënyrë konkrete pyetjet e mundshme për gratë përdoruese të drejtësisë, të tilla si broshurat, fletëpalosjet ose referimet për shërbimet lokale? A ka zona të veçanta pritjeje për njerëzit që vijnë në zyrë/gjykatë me fëmijë? A merren parasysh çështjet e sigurisë?)

...

### Fusha për diskutim

- ▶ Cilat ishin gjetjet tuaja kryesore nga "mini auditimi gjinor" në lidhje me aksesin e grave në drejtësi? Ju ka habitur ndonjë gjë? Nëse po, çfarë?
- ▶ Ku i keni konstatuar më shpesh pengesat e mundshme lidhur me aksesin në drejtësi? A ishin ato të lidhura me procedurat, me vetë hapësirën apo me diçka tjetër?
- ▶ Çfarë hapash konkretë mendoni se nevojiten për të përmirësuar aksesin në drejtësi për gratë në mjedisin tuaj të punës?
- ▶ Si do t'i përshkruani këto pengesa për sa i përket aftësisë për t'i trajtuar ato vetë?
- ▶ A do t'ju duhet të punoni me të tjerët për të përmirësuar situatën për gratë përdoruese të drejtësisë? Nëse po, me kë? Çfarë mbështetje apo burime do t'ju nevojiteshin për të trajtuar këto pengesa? Çfarë mund të planifikoni për t'u siguruar që keni mbështetjen dhe burimet e nevojshme?
- ▶ Si mendoni se do të kishte shkuar ky ushtrim nëse do ta kishit përfunduar në fillim të mentorimit (d.m.th. 8 muaj më parë)? A mendoni se do të kishit pasur një këndvështrim të ndryshëm për aksesin e grave në drejtësi në mjedisin tuaj të punës?

### Burime

Nëse të mentoruarit nuk janë të njohur me konceptin e auditimit gjinor, ata mund të lexojnë një përshkrim të procesit këtu:

<https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-audit>

Megjithatë, mentori duhet të shpjegojë qartë se nga i mentoruari nuk pritet që ai/ajo të kryejë një auditim të plotë gjinor; ushtrimi synon të jetë një proces i të parit sistematik të mjedisit të punës, duke përdorur disa metoda bazë që zbatohen në auditimet gjinore.

Në periudhën 2015-2017, sistemi gjyqësor suedez iu nënshtrua një procesi të integritetit gjinor dhe rezultatet janë dokumentuar në një raport. Ky raport mund të jetë i vlefshëm për t'u lexuar sepse përshkruan aktivitetet që janë përdorur për të vlerësuar ndjeshmërinë gjinore të sistemit gjyqësor. Mbani parasysh se seksioni 3.6.6 i raportit përshkruan se si u krye një "shëtitje gjinore në gjurmët e përdoruesve".

## Sesioni 10: Vlerësimi, hapat pasardhës dhe mbyllja

Qëllimi i këtij sesioni përfundimtar është mbyllja e procesit të mentorimit: nxjerrja e konstatimeve përfundimtare, mbledhja e arritjeve të të nxënit, vlerësimi i rezultateve dhe identifikimi i hapave për të ardhmen në mënyrë që të integrohet ajo çfarë është mësuar në punën e përditshme të profesionistëve të së drejtës.

### Objektivat e të nxënit

Mentori duhet të mbështesë të mentoruarin për të rishikuar rrugëtimin e të nxënit gjatë programit, për identifikimin e pikave të mësuara dhe për arritjen e përfundimeve rreth përvojës. Në këtë sesion, objektivi kryesor është vlerësimi i të nxënit, reflektimi mbi ndikimin dhe transferimi i të mësuarit në punën e përditshme të të mentoruarve.

Sesioni duhet të ofrojë hapësirë për komente dhe sugjerime nga ana e të mentoruarve, në lidhje me procesin e mentorimit dhe përmbajtjen e sesioneve të mentorimit.

### Ndikimi i pritshëm

Të mentoruarit duhet të jenë në gjendje të identifikojnë rezultatet e tyre më të rëndësishme të të nxënit dhe pikat që mund të integrohen në punën e tyre të përditshme nga procesi mësimor, në mënyrë që të sigurojnë akses më të mirë në drejtësi për gratë.

### Përmbajtja/temat/fushat për diskutim

- ▶ Pikat e të nxënit dhe përfundimet;
- ▶ Hapat e ardhshëm, nevojat eventuale të mëtejshme për mbështetje dhe mësim;
- ▶ Zgjerimi i ndikimit, kontaktimi me kolegëve lidhur me temën e aksesit të grave në drejtësi;
- ▶ Vlerësimi i procesit – bashkëpunimi mentor- i mentoruar;
- ▶ Komente.

### Ushtrime

Ky sesion mund të jetë veçanërisht i dobishëm për t'u bërë të paktën pjesërisht në grup, në mënyrë që rezultatet e të nxënit dhe hapat e ardhshëm të mund të frymëzojnë të gjithë të mentoruarit. Aktiviteti i vlerësimit mund të përfshijë rishikimin e shënimeve të mentorimit dhe kujtimin e pikave më të rëndësishme të diskutimit nga çdo sesion. Disa aspekte të të nxënit që mund të diskutohen janë:

- ▶ Cilat janë gjërat/praktikat që kam bërë, për të cilat jam bërë më i vetëdijshëm sa i takon rëndësisë së tyre në lidhje me aksesin e grave në drejtësi?
- ▶ A ka gjëra shtesë që do të bëj ndryshe pas këtij procesi?
- ▶ Çfarë mund të bëhet nga ana ime në të ardhmen për të siguruar akses më të mirë në drejtësi për gratë?
- ▶ Cilat raste dhe shembuj më duken më të dobishëm për praktikën time?

### Resursi

Formulari i vlerësimit përfundimtar mbi mentorimin (për të mentoruarit) - Shtojca 2.

# BURIME SHITESË PËR ZHVILLIMIN E SESIONEVE TË MENTORIMIT

---

## Këshilli i Evropës

Materiale për aksesin e barabartë të grave në drejtësi

<https://www.coe.int/en/web/genderequality/equal-access-of-women-to-justice>

Konventa e Stambollit (teksti në të gjitha gjuhët e Këshillit të Evropës)

<https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/text-of-the-convention>

Raportet e Grupit të Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO).

<https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/>

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut:

Praktika gjyqësore (baza e të dhënave HUDOC)

[https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

Fletë të dhënash mbi dhunën ndaj grave

[https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Violence\\_Woman\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Violence_Woman_ENG.pdf)

Fletë të dhënash mbi dhunën në familje

[https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Domestic\\_violence\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Domestic_violence_ENG.pdf)

Fletë të dhënash mbi barazinë gjinore

[https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Gender\\_Equality\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Gender_Equality_ENG.pdf)

Kurse online të Programit Evropian për Edukimin për të Drejtat e Njeriut për Profesionistët e së Drejtës (HELP):

<http://help.elearning.ext.coe.int>

## Burime për statistikat gjinore

Raportet e UNDP-së për Zhvillimin Njerëzor, të dhënat dhe profilet e vendeve

<http://www.hdr.undp.org/en>

<http://www.hdr.undp.org/en/data>

Baza e të dhënave e statistikave gjinore të UNECE-s

<https://w3.unece.org/PXWeb/en>

<https://w3.unece.org/PXWeb/ru>

Baza e të dhënave e Bankës Botërore

<https://databank.worldbank.org/source/gender-statistics>

## Agjencitë kombëtare të statistikave

Komiteti CEDAW

Rekomandime të përgjithshme (përfshirë aksesin e grave në drejtësi dhe dhunën ndaj grave)

<https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CEDAW/Pages/Recommendations.aspx>

Jurisprudenca

<https://juris.ohchr.org/en/search/results?Bodies=3&sortOrder=Date>

## Video

Multimedia e Këshillit të Evropës për barazinë gjinore  
<https://www.coe.int/en/web/genderequality/multimedia>

Videot e Këshillit të Evropës mbi dhunën ndaj grave  
<https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/>  
<https://www.coe.int/en/web/human-rights-channel/domestic-violence-and-violence-against-women>

Libraria digjitale e UN Women  
<https://www.unwomen.org/en/digital-library/videos>

UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore  
<https://eca.unwomen.org/en/digital-library/videos>

Barazia gjinore (dhe hendeku gjinor i pagave)  
<https://www.youtube.com/watch?v=TWvJ3Dd2Y9M>  
<https://www.youtube.com/watch?v=t2JBPBIFR2Y>  
<https://www.youtube.com/watch?v=pF1j22x-yU8>  
[https://www.youtube.com/watch?v=snUE2jm\\_nFA](https://www.youtube.com/watch?v=snUE2jm_nFA)

Steriotipet gjinore  
<https://www.youtube.com/watch?v=G3Aweo-74kY>

Integrimi gjinor  
<https://youtu.be/udSjBbGwJEg> (anglisht)  
<https://youtu.be/Dh2B7ausEJo> (gjuhën ukrainase)





## **SHTOJCAT**

---

- (1) Formulari i raportit të sesionit të mentorimit (për mentorët)**
- (2) Formulari i raportit përfundimtar të mentorimit (për të mentoruarit)**
- (3) Formulari i raportit përfundimtar të mentorimit (për mentorët)**



**Aksesi i grave në drejtësi:  
Përmbushja e kërkesave të Konventës së Stambollit dhe standardeve të tjera evropiane  
të barazisë gjinore**

**FORMULARI I RAPORTIT TË SESIONIT TË MENTORIT**

**(Shtojca 1, për mentorët)**

Ky formular raportimi do të plotësohet nga ju pas çdo sesioni mentorimi. Ju lutemi, lexojeni dhe plotësojeni formularin me kujdes pasi ai do të përdoret për dokumentacionin e Programit të Mentorimit dhe do t'i ndihmojë të tjerët të kuptojnë më mirë procesin, si e keni përshtatur programin dhe çfarë keni mësuar prej tij. Formulari është gjithashtu një mundësi unike për të kuptuar se si të përmirësohet Programin e Mentorimit bazuar në përvojën tuaj.

Mundohuni të jeni konkret në mënyrë që të kuptojmë më mirë se si kanë shkuar proceset dhe çfarë sfidash keni hasur me të mentoruarit tuaj. Përpara se të përdoret ndonjë pjesë e raportit tuaj, Këshilli i Evropës do t'ju kërkojë leje dhe do t'ju lejojë t'i modifikoni ato pjesë.

**Emri, vendi:** \_\_\_\_\_

**Sesion mentorimi individual**       **Sesion mentorimi në grup**

**Emri i të mentoruarit(ëve):** \_\_\_\_\_

**Data dhe vendi i sesionit të mentorimit:** \_\_\_\_\_

**Temat/fushat e trajtuara:**

--

**Përmbledhje e shkurtër e takimit dhe përvojave tuaja:**

--

**Rezultatet e arritura dhe sfidat e hasura gjatë takimit:**

--

**Përvojat me metodat e propozuara, gjërat që keni përshtatur ose sugjeruar t'i përdorni ndryshe:**

**Çdo koment tjetër, gjëra për t'u mbajtur mend nga ky sesion:**

Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



Bashkëfinancuar dhe  
zbatuar nga  
Këshilli i Evropës

## Aksesi i grave në drejtësi:

### Përmbushja e kërkesave të Konventës së Stambollit dhe standardeve të tjera evropiane të barazisë gjinore

## FORMULARI I VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR TË MENTORIMIT

### (Shtojca 2, për të mentoruarit)

Ky formular vlerësimi do të plotësohet nga të gjithë të mentoruarit në fund të Programit të Mentorimit, pas përfundimit të sesionit të Vlerësimit me mentorin. Ju lutemi lexojeni dhe plotësojeni formularin me kujdes pasi ai do të përdoret për dokumentimin e Programit të Mentorimit dhe do t'i ndihmojë të tjerët të kuptojnë më mirë procesin dhe atë që keni mësuar ju nga përvoja e mentorimit. Është gjithashtu një mundësi unike për të kuptuar se si të përmirësohet Programin e Mentorimit bazuar në përvojën tuaj.

Mundohuni të jeni konkret në mënyrë që të kuptojmë më mirë se si ka shkuar procesi.

**Emri, vendi:** \_\_\_\_\_

**Datat e procesit të mentorimit (data e fillimit dhe mbarimit)** – *onga takimi i parë i mentorimit deri në takimin e fundit – këtu mund të përfshihen gjithashtu takime përgatitore nëse mendoni se ato ishin pjesë integrale e procesit tuaj.*

## A. KONTEKSTI

**Konteksti në të cilin u zbatua projekti:** ju lutemi përshkruani çdo informacion kontekstual të punës suaj që mund të jetë i nevojshëm të merret parasysh kur të lexohet raporti juaj:

## B. SI E VLERËSONI JU PROCESIN

Ju lutem përshkruani përvojat tuaja me procesin e mentorimit. Cilat ishin të mësimet më të mëdha?

**Sa i dobishëm ishte Programi i Mentorimit për punën tuaj në të ardhmen?**

Aspak i dobishëm       Pak i dobishëm       I dobishëm       Shumë i dobishëm

Nëse doni të jepni komente:

**Ju lutemi vlerësoni aspektet e mëposhtme të Programit të Mentorimit:**

Rëndësia e temave të trajtuara

Jo e mirë       E kënaqshme       E mirë       Shumë e mirë

Lehtësimi nga mentorët

Jo e mirë       E kënaqshme       E mirë       Shumë e mirë

Koha e rezervuar për ushtrime praktike

Jo e mirë       E kënaqshme       E mirë       Shumë e mirë

Kohëzgjatja e Programit të Mentorimit ishte e përshtatshme

Jo e mirë       E kënaqshme       E mirë       Shumë e mirë

**Ju lutem jepni opinionin tuaj:**

Programi i Mentorimit rriti kompetencat e mia për çështje që lidhen me aksesin e grave në drejtësi dhe luftimin e dhunës ndaj grave.

Jo shumë dakort       Jo dakord       Nuk e di       Dakord       Shumë dakort

Mësova gjëra të reja që do t'i zbatoj në punën time.

Jo shumë dakort       Jo dakord       Nuk e di       Dakord       Shumë dakort

Jam i motivuar të bëhem një person burimor për kolegët e mi në lidhje me çështjet e trajtuara.

Jo shumë dakort       Jo dakord       Nuk e di       Dakord       Shumë dakort

Nëse dëshironi të jepni komente:

Jo shumë dakort       Jo dakord       Nuk e di       Dakord       Shumë dakort

**Ju lutemi jepni temat që mendoni se nuk janë mbuluar në Programin e Mentorimit, por që duhet të ishin përfshirë, ose të cilave duhet t'i kushtohet më shumë kohë:**

**Sugjerime shtesë për përmirësime (për sa i përket përmbajtjes ose organizimit të proceseve të ngjashme):**

**Faleminderit që ndatë komentet tuaja me ne!**



**Aksesi i grave në drejtësi:  
Përmbushja e kërkesave të Konventës së Stambollit dhe standardeve të tjera evropiane  
të barazisë gjinore**

**FORMULARI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MENTORIT**

**(Shtojca 3, për mentorët)**

Ky formular raportimi do të plotësohet nga ju në fund të Programit të Mentorimit, pas përfundimit të sesionit të Vlerësimit me të mentoruarit tuaj. Ju lutemi, lexojeni dhe plotësojeni formularin me kujdes pasi ai do të përdoret për dokumentacionin e Programit të Mentorimit dhe do t'ju ndihmojë të tjerët të kuptojnë më mirë procesin, si e keni përshtatur programin dhe çfarë keni mësuar prej tij. Është gjithashtu një mundësi unike për të kuptuar se si të përmirësohet Programi i Mentorimit bazuar në përvojën tuaj.

Mundohuni të jeni konkret në mënyrë që ne të kuptojmë më mirë se si kanë shkuar proceset dhe nëse keni hasur ndonjë sfidë me të mentoruarit tuaj. Përpara se të përdorë ndonjë pjesë të materialit të raportit tuaj, Këshilli i Evropës do t'ju kërkojë leje dhe do t'ju lejojë t'ju modifikoni ato pjesë.

**Emri, organizata, vendi:** \_\_\_\_\_

**Emri i të mentoruarit:** \_\_\_\_\_

**Datat e procesit të mentorimit (data e fillimit dhe mbarimit)** – nga takimi i parë i mentorimit deri në takim-in e fundit – këtu mund të përfshihen gjithashtu takime përgatitore nëse mendoni se ato ishin pjesë integrale e procesit tuaj.

**A. KONTEKSTI**

**Konteksti në të cilin u zbatua projekti:** ju lutemi përshkruani çdo informacion kontekstual të punës suaj që mund të jetë i nevojshëm të merret parasysh kur të lexohet raporti juaj:

## B. PJESËMARRËSIT

**Pjesëmarrësit:** Me kë keni punuar?

**Numrat:** Ju lutem na jepni informacion rreth të mentoruarve tuaj

Të mentoruarit	Formimi (gjyqtar, prokuror)	Numri i takimeve gjithsej	Fokusi kryesor, temat e mbuluara

## C. AKTIVITETET KRYESORE TË MENTORIMIT

**Ju lutemi jepni një përshkrim të aktiviteteve kryesore brenda procesit. Përshkrimi duhet të përfshijë:**

- ▶ Si dhe kur ndodhën proceset e mentorimit (takime individuale kundrejt takimeve në grup, përvoja me lehtësimin e procesit të mentorimit);
- ▶ Përvoja me metodologjinë dhe metodat;
- ▶ Cilat ishin rezultatet kryesore të procesit të mentorimit përsa i përket ndryshimit që patë me të mentoruarit?



## D. AKSESI NË DREJTËSI

### Cilat tema u trajtuan nga procesi dhe si?

<p>Sesionet e propozuara në Udhëzuesin e Mentorimit:</p> <p>Ju lutemi kontrolloni seancat e realizuara</p>	<input type="checkbox"/> Si lidhet “aksesi i grave në drejtësi” me mua? <input type="checkbox"/> Drejtësia “është e verbër” nuk do të thotë “e verbër në aspektin gjinor” <input type="checkbox"/> Eksplorimi i pengesave për aksesin e grave për drejtësi <input type="checkbox"/> Aksesin në drejtësi në rastet e dhunës ndaj grave <input type="checkbox"/> Zbatimi i së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e grave në gjykatat kombëtare <input type="checkbox"/> Puna me praktikën gjyqësore <input type="checkbox"/> Çfarë mund të bëhet për të eliminuar stereotipet gjinore në proceset gjyqësore? <input type="checkbox"/> Përdorimi i praktikave të ndjeshme gjinore në jetën reale <input type="checkbox"/> Mbyllja, vlerësimi dhe hapat e mëtejshëm <input type="checkbox"/> Tema ose fusha të tjera të eksploruara:
--	---

Si i trajtuat temat/sesionet e ndryshme (të zgjedhura më lart)? Si ishte përvoja juaj me tema të ndryshme? Ju lutemi, përshkruani çdo modifikim që keni bërë (p.sh. përdorimi i materialeve shtesë, fokusimi në çështje të tjera brenda temës, etj.).

Ju lutemi, na jepni objektivat origjinale të mentorimit të vendosura me secilin të mentoruar në fillim të procesit.

I mentoruari:	Objektivat e mentorimit: ▶ ... ▶ ... ▶ ...
I mentoruari:	Objektivat e mentorimit: ▶ ... ▶ ... ▶ ...
I mentoruari:	Objektivat e mentorimit: ▶ ... ▶ ... ▶ ...

**Projekti ka kontribuar për përmirësimin e aksesit të grave në drejtësi në mënyrat e mëposhtme:**

## E. REZULTATET – BURIMET DHE VËSHTIRËSITË

**Ju lutemi, rendisni ato që i konsideroni si rezultatet/ndikimin më të suksesshëm të proceseve të mentorimit.**

*Mundohuni që të jeni sa më konkret.*

**Deri në çfarë mase përputhen rezultatet me pritshmëritë dhe planet tuaja?**

*Ju lutemi, përmendni nëse janë arritur apo jo të gjitha objektivat tuaja të planifikuara, si dhe nëse ka pasur ndonjë rezultat të papritur.*

**A keni hasur ndonjë vështirësi gjatë procesit të mentorimit? Nëse po, çfarë vështirësish? Si i kapërcyjet ato?**

*Ju lutem, përmendni shembuj konkretë...*

## F. AKTIVITETET PASUESE DHE QËNDRUESHMËRIA

**A keni planifikuar ndonjë aktivitet pasues të proceseve të mentorimit?**

*Ju lutemi, përpiquini të përmendni shembuj dhe plane konkrete të të mentoruarve tuaj.*

## G. RRETH JUSH

**Ju lutem plotësoni fjalitë e mëposhtme:**

Duke qenë mentor në këtë Program mësova se ...

Motivimi më i madh që më mbajti aktiv brenda procesit të mentorimit ishte ...

Ajo që e pata më të vështirë si mentor ishte ...

Falë mentorimit, unë ...

## H. NDONJË KOMENT SHITESË

**Ju lutemi jepni komente që nuk kanë të bëjnë me pyetjet e mësipërme:**



*Ky publikim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës*

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

**[www.europa.eu](http://www.europa.eu)**

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

**[www.coe.int](http://www.coe.int)**

Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar  
nga Këshilli i Evropës